

VENDIM
Nr.774, datë 14.11.2007

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT RURAL, 2007-2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë ndërsektoriale shqiptare të zhvillimit rural, 2007-2013, sipas dokumentit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në bazë të dokumentit të strategjisë, harton planin e veprimit për zbatimin e saj. Njëkohësisht, ajo monitoron edhe zbatimin e planit të veprimit nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe raporton në Këshillin e Ministrave.

3. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave, përcaktojnë detyrat e tyre dhe raportojnë, në fund të vitit, pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për realizimin e masve të përcaktuara, në kuadër të zbatimit të planit të veprimit të strategjisë ndërsektoriale shqiptare të zhvillimit rural.

4. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit harton, çdo vit, raportin për zhvillimin rural. Struktura e raportit miratohet nga Komiteti Ndërmintor për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE SHQIPTARE E ZHVILLIMIT RURAL
(SKZHR) 2007-2013

PARATHËNIE

Strategjia kombëtare për zhvillimin rural (SKZHR) përshkruan prioritetet e politikës së zhvillimit rural të vendit tonë. Prioritetet janë përcaktuar në linjë të plotë me prioritetet e Komunitetit Europian, mbi politikat e zhvillimit rural. SKZHR-ja do të shtrihet gjatë periudhës 2007-2013 dhe do të përfshijë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Dokumenti është përgatitur sipas direktivave të përshkruara në nenin 11 të rregullores së Këshillit Europian (EC) no.1698/2005, për mbështetjen e zhvillimit rural përcaktuar nga Fondi Europian i Bujqësisë për Zhvillimin Rural (EAFRD). Prioritetet Kombëtare dhe aktivitetet janë përcaktuar në atë mënyrë dhe formë që të nxisin sinergjitë me instrumentet e tjera të financimit publik në politikat bujqësore dhe sidomos në kohezionin social dhe ekonomik, si dhe mjedisin dhe hapësirën. SKZHR-ja është hartuar në përputhje me direktivat strategjike të Komunitetit Europian dhe me direktivat më të gjera strategjike të Komunitetit për një përdorim të qëndrueshëm të burimeve (vendimi i Këshillit të Gotenborgut), si dhe me nxitjen e rritjes ekonomike dhe krijimit të vendeve të punës (Strategjia e Lisbonës).

Plani Strategjik Kombëtar (PSK) ka si synim rritjen e rolit shumëfunksional të bujqësisë shqiptare. Në fokus janë nevojat për rristurimin e bujqësisë dhe agroindustrisë, për të rritur konkurrencën në të gjithë sektorët bujqësorë dhe të zinxhirit agroushqimor. PSK-ja bazohet në parimet e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore të rinovueshme dhe i kushton vëmendje të veçantë ruajtjes së peizazhit kulturor dhe mbrojtjes së mjedisit, si dhe mirëmbajtjes së vendbanimeve dhe ruajtjes së indentitetit rural në fshat. Ajo pasqyron, gjithashtu dhe rolin multifunksional të pyjeve, të

cilat i japin Shqipërisë një peizazh unik dhe janë një element i rëndësishëm i qëndrueshmërisë së mjedisit, si dhe burim diversiteti biologjik. Prioritetet e PSK-së do të japin një kontribut të madh drejt një rritjeje social-ekonomike në zonat rurale nëpërmjet futjes së metodave të reja për rritjen e mundësive të punësimit në zonat rurale në të gjitha aktivitetet bujqësore. Plani Kombëtar Strategjik është një kuadër për t'iu referuar gjatë formulimit të programit të zhvillimit rural, 2007-2013, për të gjithë Shqipërinë.

Përgatitjet paraprake për PSK-në kanë filluar me autoritetet administrative qendrore, rajonale dhe lokale, me partner socialë dhe ekonomikë, si dhe me përfaqësues të interesuar nga shoqëria civile, ku përfshihen dhe organizatat joqeveritare. Drafti aktual i PSK-së është subjekt i një diskutimi të gjerë publik ndërmjet partnerëve që u përmendën më sipër.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria është një vend relativisht i vogël, me relief të theksuar malor dhe me një popullsi prej rreth 3.1 milionë banorësh. Vetëm 24 % e tokës së saj klasifikohet si tokë bujqësore, 36% janë pyje dhe 15 % kullota. Bujqësia vazhdon ende të zërë një peshë të rëndësishme në ekonominë e vendit, pasi ka pjesën më të madhe të popullsisë. Popullsia rurale vlerësohet të përbëjë rreth 54 % të popullsisë totale dhe 71% e popullsisë rurale është e punësuar në aktivitetin bujqësor.

Një strategji rurale e suksesshme kërkon bazë të qëndrueshme të zhvillimit makro- ekonomik, me një rritje të qëndrueshme ekonomike. Inflacion të ulët, monedhë të qëndrueshme, nivel të palëvizshëm të deficitit fiskal dhe stabilitet të jashtëm të konsoliduar. Kjo ka sjellë kërkesën për prodhime dhe shërbime bujqësore dhe kushtet për zhvillimin e tregut.

Pavarësisht nga gjithë ky zhvillim pozitiv, në Shqipëri varfëria është prezente dhe sidomos në zonat rurale. Sipas vëzhgimeve të fundit të LSMS-së 18.5% e shqiptarëve janë të varfër. Kjo shifër është edhe më e lartë në zonat rurale ku 24.2 % e popullsisë është e varfër. Ndërmjet rajoneve ka diferenca të konsiderueshme në nivelin e varfërisë. Në tri vitet e fundit varfëria urbane ka rënë më shpejt se varfëria rurale, por ka pasur edhe reduktim të diferencës ndërmjet rajoneve. Varfëria është më e lartë te familjet me shumë fëmijë me edukim shkollor të ulët, shumica e të cilëve jetojnë në zonat rurale. Për rrjedhojë, Shqipëria ka pasur migracion të shpejtë nga zonat rurale në ato urbane, që ka krijuar më shumë shkëputje sociale dhe rreze, si në familjet urbane dhe në popullsinë rurale që po plakët.

Spektori rural nuk është efikas, i dominuar nga fermat e mëdha shtetërore dhe kooperativat e krijuara para viteve 1990 ndryshe nga karakteri i fermës së vogël me bazë familjare që është sot. Fermat në Shqipëri janë të vogla me një madhësi mesatare prej 1.1 ha dhe të copëzuara. Prodhimi bujqësor është rritur, sepse pronarët e rinj të fermave nisën të punojnë intensivisht për të shtuar prodhimin. Suksesi i viteve të fundit në përmirësimin e prodhimit tregon, se mbështetja publike për modernizimin e fermave do të japë rezultate të dobishme. Megjithatë, tregjet dhe standardet e cilësisë së ushqimit janë akoma të pazhvilluara mirë në Shqipëri, në këtë mënyrë rritja e prodhimit do të kompensohet vetëm në përmirësimin e tregjeve, nëse duam që kjo rritje të jetë e qëndrueshme. Për rrjedhojë mbështetja për modernizimin e fermave dhe zhvillimin e tregjeve merr rëndësi të veçantë.

Mjedisi natyror në zonat rurale në Shqipëri, është akoma i paprishur dhe është një thesar i rëndësishëm kombëtar dhe ndërkombëtar. Mjedisi natyror është, gjithashtu një burim potencial të ardhurash për zonat rurale, nëpërmjet sigurisë që ofron për cilësinë e prodhimeve ushqimore dhe nëpërmjet rolit të saj si një atraksion për turizëm dhe argëtim.

Shqipëria rurale është më shumë e varur nga bujqësia se shumica e vendeve të Europës, ku zejtaria dhe shërbimet janë pak të zhvilluara. Modernizimi i fermave e pakëson mundësinë e punësimit në bujqësi, kështu një nga elementet kryesore është diversifikimi i veprimtarive ekonomike.

Infrastruktura rurale është ende e pazhvilluar me kërkesat e kohës: rrugët janë në kushte të këqija; furnizimi me ujë shpesh ndërpritet dhe shumë pak fshatra i kanë organizuar sistemet sanitare. Përmirësimi i infrastrukturës rurale është një prioritet i rëndësishëm për ekonominë rurale dhe për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe reduktimin e migrimit rural-urban.

Problemet kryesore të paraqitura më sipër janë parashtruar edhe para shumë vendeve Europiane dhe Strategjia Shqiptare e Zhvillimit Rural është mbështetur në eksperiencën e BE-së me zhvillimin rural. Shtyllat kryesore për zhvillimin rural në Shqipëri janë: a) rritje e qëndrueshme e të ardhurave nga fermat; b) menaxhimi i burimeve natyrore duke përfshirë pyjet, kullotat dhe ujin; dhe c)

krijimi i mundësive të reja për punësim dhe cilësi më e mirë jetese, nëpërmjet diversifikimit dhe përmirësimit të infrastrukturës rurale. Këto tri shtylla janë të barasvlefshme me tri akset kryesore të miratuara në udhëzimet e BE-së për zhvillimin rural dhe në mbështetjen e BE-së për vendet aderuese dhe paraaderuese. Këto prioritetë do të bëjnë të mundur reduktimin e varfërisë. Strategjia shqiptare, gjithashtu ndjek praktikën e BE-së në identifikimin e aksit të katërt, bazuar në iniciativat lokale të planifikimit zhvillimor, të cilat kanë një buxhet të caktuar dhe integrohen në hartimin e aktiviteteve të akteve të tjera. Brenda secilës shtyllë janë përcaktuar një numër masash.

Shqipëria tashmë ka përcaktuar në buxhetin e saj rreth 7 bilionë lekë për zhvillimin rural, nga një total për investimet publike prej 40 bilionë lekësh. Shpenzimet aktuale dominohen nga investimet në ferma dhe infrastrukturë.

Tabela e mëposhtme përmbledh masat e përcaktuara në strategjinë e zhvillimit rural, bashkë me shpërndarjen e shpenzimeve aktuale dhe shpërndarjen e planifikuar deri në përfundim të strategjisë. **Kalimi nga shpenzimi aktual në shpenzimin në fund të periudhës do të ndahet në faza gjatë zbatimit të strategjisë.**

Tabela 1 Strategjia e Zhvillimit Rural për Shqipërinë: Akset, masat dhe prioritetet

	Ekzistuese 2006	Të planifikuara 2013	
Aksi 1	m lekë	m lekë	% në total
Modernizimi i fermës	2 633	4 675	27.5%
Vlera e shtuar/marketingu	210	2 550	15.0%
Pyjet	369	850	5.0%
Trajnime shërbimi këshillimor	0	425	2.5%
Totali	3 213	8,500	50.0%
Aksi 2			
Zonat më pak të favorshme	1 558	170	1.0%
Agromjedisi dhe natyra 2000		1 530	9.0%
Totali	1 558	1 700	10.0%
Aksi 3			
Punësimi në aktivitete jobujqësore	0	1 190	7.0%
Cilësia e jetës rurale/infrastruktura	2,583	4 760	28.0%
Totali	2,583	5 950	35.0%
Aksi 4			
Pjesëmarrës në zhvillim	0	850	5.0%
Totali i përgjithshëm	7 355	17 000	100.0%

Përveç kësaj, gjatë identifikimit të programeve të mësipërme, strategjia e zhvillimit rural, gjithashtu shtrihet në fusha si arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik dhe infrastrukturës, të cilat nuk mbulohen nga investimet lokale. Këto aktivitete që bëjnë pjesë në zhvillimin rural do të monitorohen nëpërmjet sistemit të raportimit rural “rural proofing”, i njëjtë me sistemin e zhvilluar në vendet anëtare të BE-së. Secila nga ministritë e përfshira (sidomos arsimi, shëndetësia, ekonomia dhe transportet) duhet të dërgojnë një raport vjetor “rural proofing” që paraqet programet e tyre për zonat rurale, krahasuar me programet për zonat urbane, ku përfshihen të dhënat për shpenzimet për frymë.

Sipas NSP-së, do të përgatitet një plan veprimesh për zhvillimin rural në të gjithë territorin e Shqipërisë. Zbatimi i politikës së zhvillimit rural gjatë periudhës afatmesme, do të kryhet nga agjencia rurale e pagesave, e cila do të organizohet si një institucion i pavarur nën ombrellën e MBUMK-së me mbështetjen e një sërë agjencish shtetërore në nivele të ndryshme.

I. VLERËSIMI I SITUATËS SOCIAL–EKONOMIKE, MJEDISORE DHE POTENCIALI PËR ZHVILLIM

I.1 Historiku

Territori i Shqipërisë është 28 000 km katror me një popullsi rreth 3.1 M. Popullsia është e

vendosur në zonën bregdetare, e cila mbulon 25% të territorit. Mbi 60% e vendit është zonë malore. Në dhjetë vitet e fundit ka pasur lëvizje të mëdha të popullsisë, ku me rëndësi është migrimi i madh nga zonat rurale, sidomos në drejtim të Tiranës. Popullsia e zonave rurale ka rënë nga 65% në 55%.

Varfëria në Shqipëri ka qenë e lartë, por është ulur me 18.5 % për të gjithë shqiptarët, gjysma e tyre jetojnë në varfëri ekstreme. Një në tri familje ka mangësi në infrastrukturën bazë. Vdekshmëria foshnjore dhe vdekshmëria të fëmijët nën moshën pesë vjeç, është relativisht e lartë, krahasuar me ato të vendeve të tjera në rajon dhe pothuaj një në çdo shtatë fëmijë nën moshën pesë vjeç, është i keqshqyer. Është rritur mungesa e shkollimit dhe tre të katërtat e familjeve të varfra kanë probleme akute sociale. Mundësia e të jetuarit në varfëri rritet paralel me rritjen e madhësisë së familjes, e cila është e lidhur ngushtë me papunësinë.

Njerëzit që jetojnë në zonat rurale janë shumë më të varfër se ata që jetojnë në zonat urbane. Varfëria ka shumë dimensione: a) nivel i ulët ose shumë i ulët i të ardhurave të të varfërve; b) mundësia më e lartë e sëmundshmërisë dhe mungesa e shërbimeve të duhura mjekësore; c) mungesë shkollimi ose nivel i ulët arsimimi; dhe d) mundësi e kufizuar tek institucionet vendimmarrëse shtetërore. Sidomos i lartë është niveli i varfërisë për ato grupe për të cilët bujqësia është burimi i vetëm i të ardhurave. Kjo vihet re sepse 50% e të varfërve janë fermerë.

Urbanizimi ka treguar potencialin e tij në uljen e varfërisë. Varfëria urbane ka rënë më shpejt se varfëria rurale, ku varfëria në zonat urbane ka rënë nga 19.5 në 11.2 për qind nga viti 2002 në vitin 2005, ndërsa varfëria rurale është ulur nga 29.6 në 24.2 %. Një zhvillim dramatik është vënë re në rajonet malore, i cili ka pasur nivelin më të lartë të varfërisë në vend deri në vitin 2002, por që nga 2005 ka arritur t'i afrohet mesatares rurale në nivel kombëtar. Kjo ka ndodhur për shkak të nivelit të lartë të dërgesave nga jashtë në drejtim të zonave malore, si nga zonat urbane dhe nga jashtë kufijve të Shqipërisë. Përveç rëndësisë që kanë dërgesat e parave nga jashtë, ka gjithashtu evidencë të rritjes së varfërisë brenda në Tiranë, në zonat me banorë të rinj. Aksesit në infrastrukturë dhe shërbimet bazë është, gjithashtu, i dobët në krahasim me qytetin.

Migrimi rural-urban tregon një transformim të thellë strukturor të ekonomisë shqiptare duke mos marrë parasysh bujqësinë dhe industrinë tradicionale dhe duke ecur drejt sektorëve me rendiment të lartë, ku përfshihen tregtia dhe shërbimet, turizmi dhe ndërtimi. Bujqësia ka luajtur tradicionalisht një rol të rëndësishëm në ekonomi me 24% të GDP-së dhe 58% të punësimit gjatë vitit 2004. Sfidat e këtij sektori do të jetë modernizimi i prodhimit bujqësor, diversifikimi drejt agropërpunimit, duke e ngritur cilësinë në mënyrë të mjaftueshme për të konkurruar në tregjet europiane dhe duke kultivuar produkte cilësore për të cilat edhe kërkesa në vend do të rritet me rritjen e të ardhurave.

Pavarësisht nga sfidat e zonave rurale, akoma ka mundësi për përmirësimin e situatës bazuar në: një mjedis të favorshëm natyror dhe pozitë gjeografike; paga krahasimisht të ulëta; një popullatë relativisht e arsimuar, ku përfshihen edhe shumë të rinj; aftësi tradicionale për punët e bujqësisë dhe një kulturë të fortë lokale; si dhe furnizimin me energji të zonave rurale më të zhvilluara.

I.2 Bujqësia, pyjet dhe industria e agropërpunimit

Toka bujqësore zë 24% të sipërfaqes së përgjithshme të tokës, ku pyjet zënë 36%, kullotat dhe livadhet 15% dhe të tjerat 25%. Nga e gjithë toka bujqësore 43% është fushë, 34% është tokë kodrinore dhe 23% është tokë malore. Bujqësia është e bazuar kryesisht te fermat e vogla (më pak se 1.2 hektarë) e ndarë në 3 deri në 4 parcela. Kjo ndarje është një pengesë e madhe për një zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë shqiptare.

Bujqësia përbën rreth 23% të **vlërës së shtuar** bruto vendase dhe rritet me 3% në vit në terma real. Por, për shkak të ritmeve më të larta të ekonomisë në tërësi, pjesa që zë bujqësia në GDP-në ka rënë disi. Në zonat rurale, bujqësia përbën 71% të punësimit ku shumica e punëve bujqësore janë punë me kohë të pjesshme. Sipas të dhënave zyrtare blegtoria zë 45 % të prodhimit të përgjithshëm bujqësor, bimët e arave 44 % dhe pemëtaria 11 %. Gjatë viteve të fundit, rritjen me të madhe e ka pasur vreshtaria (me pothuaj 7% në vit) dhe sidomos vreshtat. Edhe pemët frutore dhe vreshtat kanë mundësi për rritje të mëtejshme. Blegtoria është rritur me rreth 3%. Më shumë se 60% e popullsisë merret me rritjen e bagëtive, ku blegtoria luan një rol kryesor në sistemin e fermave ku punohet me kohë të pjesshme, si dhe në sigurimet shoqërore. Pjesa më e madhe e bagëtive mbahen për prodhimin e qumështit që përdoret kryesisht për konsum familjarë. Prodhimi i qumështit has me probleme të sigurisë së ulët të cilësisë. Bagëtitë, gjithashtu përdoren edhe për transport dhe për punimin e tokës. Të lashtat kryesore janë foragjeret dhe drithërat dhe gjatë pesë viteve të fundit, prodhimi i tyre ka pasur rritje të vogël.

Bujqësia në Shqipëri vuan nga shkalla e ulët e **konkurrueshmërisë** dhe prodhuesit lokalë janë të detyruar të pranojnë të ardhura të ultë duke mos konkurruar me produktet e importuara. Statistikat zyrtare kanë marrë parasysh feramat e mëdha dhe më formale dhe në këtë mënyrë, mund të mos i pasqyrojnë si duhet disa probleme. Sipas këtyre të dhënave zyrtare, prodhimi i drithërave është ndërmjet 3 dhe 3.5 ton/ha, e ngjashme me prodhimin e vendeve të Europës Lindore dhe rreth 65% e prodhimit mesatar të drithërave në vendet e BE-së. Prodhimi i drithërave ka një rritje graduale dhe të konsiderueshme këto 5 vitet e fundit, ndërsa toka për rritjen e drithërave po pakësohet gjithnjë e më shumë duke lënë të nënkuptuar që ka një tendencë drejt përqendrimit të prodhimit të farërave me produktive. I vetmi përjashtim ndaj kësaj tendence bëhet për të mbjellat me foragjere, ku edhe prodhimi është më i ulët, por ama sipërfaqja e mbjellë nuk ka pësuar shumë ndryshime. Sipërfaqet e mbjella me drufrutorë dhe vreshta janë në rritje, bashkë me rritjen e prodhimit të drurëve frutorë.

Statistika zyrtare për prodhimin e mishit të viçit është rreth 100 kg peshë e therur/vit, mund të thuhet që është pranë normave të BE-së, tradicionalisht ky prodhim rritet në mënyrë natyrale në zonat më të izoluara të vendit. Kjo praktikë tradicionale e rritjes së kafshëve është më shumë e përhapur sesa në bujqësinë europiane që mund të sigurojë një burim të rëndësishëm për cilësi të lartë prodhimi dhe ka potenciale të mira tregu, nëse i bëhet marketingu i duhur. Të pakta janë mundësitë për përdorimin e tokave malore.

Vetëm 73% e familjeve që merren me bujqësi, e kryejnë punimin bazë të tokës me mjete të mekanizuara. 24% e punojnë tokën me kafshë dhe 63% e fermerëve përdorin mekanikën për punimin e tokës, por edhe punën e dorës. Punimi i tokës me krahë është i përhapur sidomos në zonat malore me sipërfaqe toke të vogla 0.1 në – 1.02 hektarë, ku 75% e fermerëve bëjnë punë manuale. Punimi i tokës me dorë nuk është një traditë e zonave malore ose zonave të tjera. Punimi manual i tokës është një praktikë, e cila nuk shkaktohet nga mungesa e mekanikës, pasi në Shqipëri ka 1 traktor për 50 ha. Punimi manual ndodh për shkak se të ardhurat e pakta që nxirren nga parcelat e vogla nuk mjaftojnë për të mbuluar tarifat e larta të punimeve të mekanizuara.

70% e fermerëve blejnë farëra, plehra kimike dhe pesticide. Pjesa më e madhe e fermerëve të tokave e blejnë lëndën e parë. Shpenzimi më i madh bëhet për plehurat kimike që zënë rreth 40% të shpenzimeve të prodhimit. Rreth 40-45% e fermerëve blejnë ushqime për blegtorinë. Shumica e ushqimeve të blegtorisë blihet nga fermerët e zonave malore si rezervë ushqimore në stinën e dimrit, megjithëse përdoret edhe për qëllime të tjera.

Si rezultat i efikasitetit të kufizuar të bujqësisë shqiptare, prodhimi dhe të ardhurat nga bujqësia janë të ulëta, krahasuar me standardet e BE-së. Bazuar në vlerësimin kombëtar vlera e shtuar e produkteve bujqësore dhe e zhvillimit rural është rreth 155 bn lekë. Përafërsisht rreth 756 000 njerëz janë të punësuar në bujqësi dhe vlera e shtuar për punëtorë është afërsisht 200 000, lekë ose 1,700 €. E krahasuar me shifrat e 15 vendeve të BE-së që janë rreth 26 000 € dhe 6500 € për vendet hyrëse. Të ardhurat në fermë (në lekë) nga blegtoria janë 2.7 herë më shumë se të ardhurat nga bujqësia.

Popullsia fermere është relativisht e re, ku 53% janë nën 55 vjeç dhe 24% të tjerë nën 65 vjeç. Në 95% të fermave punojnë kryesisht burra.

Shqipëria ka **deficit** të lartë **tregtar të prodhimeve bujqësore**, ku eksportet zënë më pak se 15% të importeve. Por në vitet e fundit, ky proporcion është përkeqësuar, me rënien e eksportit të prodhimeve bujqësore dhe rritjen e importeve. Kjo shkaktohet pjesërisht nga mungesa e konkurrencës, gjë që pasqyrohet në çmimet e larta të prodhimeve bujqësore në Shqipëri. Pozita e dobët tregtare tregon për prezencën e një sërë problemesh si: mungesa e organizimit të eksportuesve; kushte të pafavorshme të rrjetit tregtar; dhe probleme të kontrollit të cilësisë. Marrëveshjet e tregtisë së lirë (brenda rajonit dhe BE-së) inkurajojnë importin e prodhimeve bujqësore, por ofrojnë edhe mundësi për eksport sidomos për prodhime të veçanta si frutat, vaj ulliri, peshk dhe prodhime blegtorale. Për shkak të mentalitetit të gabuar të popullsisë se prodhimet bujqësore të importuara janë të një cilësie më të lartë, bën që shpesh këto prodhime të kenë çmime më të larta se prodhimet vendase.

Agropërpunimi zë rreth 40% të agroindustrisë dhe përbëhet nga ndërmarrje private të vogla; ish-ndërmarrjet shtetërore të privatizuara (të cilat prodhojnë kryesisht bukë, miell, qumësht dhe pije); dhe iniciativa private nëpërmjet investimeve të reja. Para vitit 1990, industria ushqimore grumbullonte dhe përpunonte rreth 50-80 % të gjithë prodhimet bujqësor, duke komercializuar të gjithë prodhimin e fermave shtetërore dhe duke punësuar rreth 47 000 vetë. Aktualisht ekzistojnë 2060 ndërmarrje të industrisë ushqimore, (nga të cilat 46% në industrinë e miellit dhe bukës), që kanë punësuar rreth 9900 persona. Përpunimi i ushqimeve është duke u rritur me shpejtësi me rreth 10% në vit dhe aktualisht

është baras me 20% të vlerës së shtuar të prodhimit bujqësor. Përpunimi i qumështit dhe i mishit kanë pësuar një rritje të konsiderueshme. Po zhvillohet agropërpunimi modern (si p.sh. perimet e ngrira) nëpërmjet importimit të materialeve të para. Eksporti i ushqimeve të përpunuara arrin në rreth 10% të vlerës së importit të prodhimit të ushqimit të përpunuar.

Investimet në agrobiznes gjatë këtyre pesë viteve të fundit janë trefishuar duke arritur në 2.9 bilionë lekë. Rritja ka ndodhur si në teknologjinë e prodhimit dhe te ndërtesat dhe një pjesë e madhe e kësaj rritjeje është financuar nga rritja e kredive bankare, e cila tashmë përbën rreth gjysmën e investimit total në agroindustri. Megjithë këto përmirësime, ndërmarrjet e përpunimit të ushqimit janë të vogla dhe shumë prej tyre nuk përbushin standardet e sigurisë ushqimore. Për rrjedhim, këto produkte nuk kanë shans të eksportohen në tregjet e BE-së. Programi i zhvillimit rural do ta prekë këtë problem duke siguruar mbështetje për agroindustrinë.

Rolet kryesore të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit janë përcaktimi i politikave dhe kuadrit ligjor dhe zhvillimi i rregulloreve, që do të bëjnë të mundur që bujqësia dhe agrobiznesi në Shqipëri, të jetë efikas dhe i suksesshëm dhe të sigurojnë shërbime për fermerët e vegjël ku përfshihen ekstensionit, kërkimi, kontrolli i sëmundjeve të bagëtive dhe mbrojtja e bimëve.

Ministria duhet të përmirësojë efikasitetin e kërkimeve nëpërmjet: a) një programi, i cili synon kërkime të përshtatura; b) reduktimi i numrit të mjeteve kërkimore dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve ekzistuese; dhe (c) përcaktim i qartë i prioritetëve kërkimore që pasqyrojnë nevojat për zhvillimin e Shqipërisë. Këto ndryshime kanë për qëllim nxitjen e kërkimeve sipas kërkesave me kosto të ulët dhe zgjidhje të efektshme të problemeve të fermerëve. Sistemi do të inkurajojë një lloj konkurrence në shpërndarje, sidomos në prodhimin e farërave dhe vaksinave.

Gjatë dekadës së fundit, shërbimet e ekstensionit janë fuqizuar shumë dhe ka shërbime në të gjitha rrethet. Ministria ka për qëllim të krijojë lidhje më të fortë ndërmjet shërbimit dhe sektorit privat për krijimin e qendrave këshillimore, të cilat do të japin këshilla në shumë fusha duke qenë gjithnjë e më shumë autosuficiente. Këshillimi për fermerët e mëdhenj dhe agrobiznesin do t'i lihet sektorit privat dhe ministria do të ndajë informacionin me sektorin privat, që t'i japë atij mundësi zhvillimi. Shërbimi i ekstensionit publik do të fokusohet gjithnjë e më shumë te fermerët e vegjël dhe të mesëm, sidomos tek ata që janë të orientuar drejt tregut. Kjo metodë do të përbehet nga: përmirësimi i cilësisë së materialeve të ekstensionit; rritja e kapaciteteve këshilluese; fokusimi te grupet e fermerëve; përmirësimi i lidhjeve ekstension-kërkime; trajnimi i vazhduar për fermerët e vegjël, ku përfshihet dhe buxhetimi për fermat; dhe sigurimi i informacionit mbi tregun. Aktualisht, në Shqipëri po pilotohen skema grantesh konkurruese me objektiv nxitjen e pjesëmarrjes së fermerëve.

Shërbimet e ekstensionit do të luajnë një rol të rëndësishëm në futjen dhe zbatimin e politikave të reja të zhvillimit rural dhe bujqësisë në Shqipëri. Në veçanti, shërbimi i ekstensionit do të marrë rëndësi gjatë vënies në zbatim të legjislacionit të ri, sidomos në fazën e përgatitjes së Shqipërisë për anëtarësim në BE. Për këtë arsye, ai duhet organizuar si një shërbim fleksibël dhe efikas. Për organizimin e këtij shërbimi MBUMK-ja ka nisur disa veprimtari.

Shërbimet veterinarë, bëjnë kontrollin dhe eliminimin e sëmundjeve. Atje ku sëmundja përbën rrezik për shëndetin publik. Ministria do të vazhdojë ta mbajë shërbimin megjithëse ajo, për disa veprimtari, mund të kontraktojë dhe sektorin privat, aty ku e sheh të arsyeshme. Për ato sëmundje që nuk paraqesin rrezik për shëndetin publik, Ministria po përpiqet të gjejë teknika të ndryshme për të nxitur besimin për veterinerët e sektorit privat. Sektori privat do të menaxhojë shërbimet e mbarështimit, ndërsa shërbimi veterinar shtetëror do të përgjigjet për rregulloren dhe monitorimin.

Shërbimi veterinar, bashkë me shërbimin për mbrojtjen e bimëve, do të jenë institucionet më të rëndësishme për krijimin dhe vënien në zbatim të politikave të përshtatshme për sigurinë ushqimore. Organizimi efikas dhe zbatimi i suksesshëm i politikës për sigurinë ushqimore në Shqipëri do t'i vijë në ndihmë fermerëve dhe industrisë agroushqimore për të përbushur kërkesat e BE-së për sigurinë e ushqimeve, e cila do të ndihmojë në krijimin e mundësive për eksport për Shqipërinë në të gjitha tregjet europiane dhe botërore.

Shumë tregtarë privatë dhe dyqane të vogla ofrojnë aktualisht materiale për mbrojtjen e bimëve, megjithëse përdorimi i tyre në shkallë kombëtare është ende i ulët. Shërbimi i mbrojtjes së bimëve përgjigjet për funksionin rregullues dhe kontrollues, përfshi këtu: karantinën e pesticideve; licencimin e shitjeve; inspektimin e ambienteve të shitjes dhe kushteve të magazinimit; diagnostikimin dhe monitorimin e epidemive të dëmtuesëve dhe sëmundjeve. Rregullat janë të pranuar, Ministria po

përmirëson mënyrën e vënies në zbatim kryesisht: duke përmirësuar informacionin për tregtarët e pakicës; duke fuqizuar rregullat e magazinimit dhe asgjësimit; duke testuar prodhimet e importuara apo të prodhuara në vend; dhe duke analizuar prodhimet bujqësore dhe ujin për pesticidet dhe mbetjet e tjera. Kjo kërkon trajnim dhe racionalizimin e laboratorëve dhe bashkëpunimit me ekstensionin dhe kërkimet.

Përmirësimi i funksioneve të qeverisë në bujqësi do të plotësojë procesin e decentralizimit në të gjitha hallkat e shtetit, e cila do të bëjë të mundur një bashkëpunim më të efektshëm me pushtetin lokal në shumë veprimtari.

Për zbatimin e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural në Shqipëri, duhet ngritur Agjencia Rurale e Pagesave. Ky është një kusht paraprak bazë për përgatitjen e Shqipërisë për mbështetje nga BE-ja para aderimit dhe do të jetë thelbësore në zbatimin afatgjatë të zhvillimit rural. Aktualisht, nuk ekziston asnjë institucion që mund ta luajë këtë rol.

Shqipëria ndoshta ka shkuar më tej se çdo vend tjetër në rajon për të zbatuar një reformë të tokës sa më të plotë, si një parakusht për zhvillimin e tregjeve të tokës. Si rezultat i kësaj reforme, peizazhi rural është transformuar në mënyrë drastike që prej vitit 1991, në të gjitha fermat kolektive të shpërbëra dhe afërsisht 98 për qind të tokës bujqësore (546 000 ha) të shpërndarë për ekonomitë e vogla private. Kjo reformë ka transformuar prodhimin e drithërave nga një strukturë e kolektivizuar dhe e komanduar, në një sektor plotësisht privat me ekonomi të vogla private dhe parcela të vogla dhe të fragmentuara që prodhojnë si për konsum familjarë, ashtu edhe për treg. Toka për kullota dhe pyjet nuk kanë qenë në pjesën më të madhe pjesë e procesit të privatizimit. Vetëm së fundmi, pronësia shtetërore është transferuar në komunitete dhe persona privatë. Legjislacioni aktualisht në fuqi ofron një kuadër të përshtatshëm ligjor dhe rregullator mbështetës për funksionimin e tregut të tokës. Regjistrimi fillestar është një proces sistematik dhe rreth 55% e tokës rurale të shpërndarë është vëzhguar, regjistruar, dhënë në pronësi. Ka akoma disa sfida, ku përfshihen edhe problemet me politikën e rikthimit dhe kompensimit. Puna më e madhe është përqendruar në zonat urbane dhe peri-urbane, që nuk janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë, por që kanë potencial të madh për zhvillimin e hortikulturës.

Fatkeqësisht, pronarët e rinj që dolën nga procesi i privatizimit dhe regjistrimit nuk kanë dëshirë ta shesin tokën. Për rrjedhojë, progresi për konsolidimin, i cili duhet të ndodhë për të kthyer fermat e vogla në ferma moderne, ka qenë i pakët. Qeveria është angazhuar për përmirësimin e tregut të tokës për të ulur koston dhe vonesat, të cilat lidhen me konsolidimin.

Megjithë reformën e gjerë mbi tokën dhe ndryshimet e konsiderueshme pozitive, reforma pati disa rezultate negative. Sot, problemi kryesor është se toka është shumë e fragmentuar dhe madhësia mesatare e fermës, shumë e vogël. Një gjë e tillë mund të krijojë probleme gjatë adoptimit të masave të reja të politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural, pra është e një rëndësie kritike përfundimi i procesit të regjistrimit të tokës. Fermat e vogla dhe të copëtuara nuk do jenë në gjendje të investojnë apo të modernizojnë fermat me efektivitet dhe të ulin koston në mënyrë që të jenë më konkurrense dhe fleksibël në tregjet e brendshme dhe sidomos në tregjet ndërkombëtare.

Infrastruktura në zonat rurale pothuaj nuk ekziston dhe sidomos në zonat me të thella malore. Banorët e zonave të thella rurale shpesh flasin për mungesën e infrastrukturës bazë (sidomos rrugët, ujin, ujtitjen dhe korrentin) si një nga faktorët pengues dhe një nga shkaqet e migracionit. Migrimi drejt qyteteve e rëndon më shumë infrastrukturën urbane dhe balanca ndërmjet investimeve në infrastrukturën urbane dhe rurale, është një çështje e rëndësishme në Shqipëri.

Problemet e furnizimit me ujë, higjienës dhe mbledhjes së mbeturinave, në zonat rurale janë problemet më të rëndësishme të infrastrukturës. Vetëm 70.5% e të gjitha qyteteve kanë një sistem të ujërave të zeza dhe vetëm 2.1% e fshatrave. Organizimi i mbledhjes së mbeturinave të familjeve i shërben 80 % të popullatës totale të Shqipërisë, gjithashtu vetëm 33% e popullatës në fshat ka akses. Infrastruktura e furnizimit me ujë të vendit i shërben 98% të gjithë popullatës, por për shumë dekada ajo është lënë pas dore dhe ka nevojë për riparim. Problemet me kryesore janë: a) konsumi i tepërt si rezultat i përdorimit të ujit të pijshëm për bujqësinë; b) mungesa e kontrollit mbi konsumin faktik përfshirë çmimin e ulët të ujit dhe nivelin e ulët të faturimit; c) institucione të pakonsoliduara të furnizimit me ujë; dhe d) mungesa e një strategjie për të përmirësuar shërbimet. Përmirësimet në zonat rurale lidhen ngushtësisht me procesin e decentralizimit, i cili i kalon përgjegjësinë e furnizimit me ujë

te pushteti vendor. Reformat për furnizimin me ujë dhe higjienën janë përcaktuar te strategjia e furnizimit me ujë dhe higjienës e zonave rurale .

Rehabilitimi i sistemeve të ujitjes dhe kullimit duhet të vazhdojë edhe në vitet në vazhdim. Shoqatat e përdoruesve të ujit (SHPU) provuan se ishin mekanizma të përshtatshëm për të menaxhuar infrastrukturën ujëtare dhe shpërndarjen e ujit në nivelin lokal dhe përmirësuan në mënyrë të konsiderueshme aksesin dhe menaxhimin e burimeve ujore në nivelet lokale. Bazuar në këto suksese, duhet që t'i kushtohet më shumë vëmendje ndërtimit të kapaciteteve të strukturave që koordinojnë dhe lehtësojnë funksionimin e kanaleve të mëdha, ndërsa ruhet koncepti i menaxhimit të sistemit nga përdoruesit. Përveç kësaj, fermerët duhet të përfitojnë më shumë këshillim në lidhje me përdorimin eficient të ujit për ujitje dhe menaxhimin e përmirësuar të burimeve, si dhe administrimin e qëndrueshëm.

Rrjeti i rrugëve rurale është shumë i dobët dhe në kushte të këqija dhe përmirësimet janë shumë të rëndësishme për zhvillimin rural. Këto vitet e fundit, me ndihmën e donatorëve janë përmirësuar një numër rrugësh rurale. Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve rurale është kaluar në kompetencë të pushtetit lokal dhe komuniteteve. Sidoqoftë, kjo veprimtari nuk ka arritur në zonat më të thella. Qeveria e pranon se në të kaluarën i është kushtuar shumë pak vëmendje mirëmbajtjes së rrugëve ekzistuese dhe për këtë arsye Qeveria do të rishikojë buxhetin për transportin në mënyrë që të alokojë më shumë burime për mirëmbajtje. Po shihet mundësia për një pjesëmarrje më të madhe të komuniteteve në ndërtimin e rrugëve rurale.

Aksesi në furnizimin me energji është i rëndësishëm. Problemet në vijimësi, që lidhen me furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë, vazhdojnë të pengojnë zhvillimin, veçanërisht zhvillimin e bizneseve dhe industrive rurale. Rrjeti i furnizimit me energji ka një shtrirje të gjerë, por gjithsesi pjesa më e madhe e zonave rurale marrin energji vetëm për disa orë në ditë si pasojë e ndërprerjeve të energjisë apo problemeve në furnizim. Nuk ka as mirëmbajtje, as shtrirje apo përmirësim të rrjetit energjetik dhe vështirësitë shkaktohen nga shfrytëzimi jo i ligjshëm i energjisë, arkëtimet e dobëta të faturave dhe çmimet e aplikuara nën koston e energjisë së importuar. Kohët e fundit, ka pasur disa përmirësime, por ndërprerjet mbeten ende të shpeshta dhe zonat rurale furnizohen me më pak energji sesa ato urbane. Gjithashtu, ka pasur edhe një lloj interesimi për të gjetur burime alternative të gjenerimit të energjisë në zonat rurale.

I.3 Mjedi rural

Shqipëria ka një mjedis relativisht të pacenuar. Megjithatë, këto kohët e fundit janë venë re probleme të rëndësishme të erozionit, përmytjeve dhe tharje të rezervuarëve, të shoqëruara me shpyllëzim dhe zënien e lëndinave dhe kullotave. Këto ndryshime kanë shkaktuar humbjen e habitateve dhe reduktimin e biodiversitetit.

Tokat kanë marrë shumë pak plehërim që prej vitit 1991, duke rezultuar në një shkatërrim të përbërjes organike, nitrogjenit dhe potasiumit. Përveç degradimit të pjellorisë së tokës, vihet re edhe një rënie e kapaciteteve ujëmbajtëse dhe një shfaqje më e shpeshtë e barërave të këqija dhe sëmundjeve të bimëve. Ka edhe disa zona të ndotjes industriale, për shembull në Elbasan dhe Shkodër. Erozioni i dheut është rritur shumë me pakësimin e vegjetacionit për shkak të shpyllëzimit, ndërtimeve dhe nxjerrjes së çakllit nga lumi. Kjo ka pasur një ndikim të madh jo vetëm mbi prodhimtarinë e tokës, por dhe mbi akumulimin e sedimentit në rrjedhat e ujit, digat dhe ekosistemet e zonave lagunore dhe bregdetare. Përmytja është një problem shqetësues në rritje, veçanërisht në pjesën veri-perëndimore të Shqipërisë, ku menaxhimi i burimeve ujore është i keq dhe infrastruktura kulluese po degradon. Sipërfaqja totale e përmytur është më shumë se 40 000 hektarë.

Pyjet përbëjnë rreth 37 % të sipërfaqes së përgjithshme të vendit dhe përfaqësojnë një bazë shumë të rëndësishme të burimeve natyrore. Vitet e fundit ka rënë siguri i lëndës drusore dhe pyjet janë dëmtuar nga prerjet e paplanifikuara për ngrohje vetjake, ndërtimeve ilegale dhe presionit për hapësira të gjelbra. Kjo ka pasur ndikim të madh mbi erozionin, përmytjet dhe mbushjen me sedimente dhe ka çuar në reduktimin e biodiversitetit. Ekzistojnë potencialet me të cilat sektori mund të rrisë kontributin e tij në rimëkëmbjen ekonomike, duke gjeneruar të ardhura nga shitja e lëndës drusore, duke rritur punësimin rural dhe duke sjellë përfitime për mjedisin. Strategjia e zhvillimit pyjor e vitit 2004 ka objektivat e mëposhtëm: a) përmirësimin e sipërfaqeve të degraduara pyjore dhe për kullota në pronësi të shtetit dhe sensibilizimi për një shfrytëzim të qëndrueshëm të tyre; b) nxitjen e ruajtjes së ekosistemeve pyjore natyrore; dhe c) intensifikimin e transicionit të pylltarisë/sectorit të kullotave drejt një ekonomie tregu, duke ndarë funksionet komerciale nga ato rregullatore dhe krijimi i

mekanizmave për vetëfinancimin e aktiviteteve tregtare. Këto hapa do të kërkojnë reforma institucionale për administratën pyjore/kullotave përfshirë krijimin e një njësie të menaxhimit mjedisor të pylltarisë dhe reformë në fushën e politikave që lidhen me kontrollin mbi prerjet ilegale në pyje, si dhe reforma në marketing dhe çmime. Strategjia përforcon parimin e decentralizimit dhe transferimit të pronësisë të pushteti lokal, por me kusht që ato të sigurojnë dhe venë në zbatim një plan për përmirësimin e pyjeve. Kjo do të mbështetet me krijimin e një kadaestre për pyjet. Theks i veçantë duhet të vihet drejt një metode me pjesëmarrje në procesin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave shtetërore nga komunitetet lokale.

Shqipëria ka një larmi biologjike dhe relievi, që bën të mundur rritjen e një game të gjerë bimësh dhe specesh shtazore. Vlerësohen 3 200 lloje bimësh vaskulare dhe 756 specie vertebrorë në vend. Rreth 30 për qind e të gjithë florës europiane është e pranishme në Shqipëri, ndërsa pyjet e lartë janë strehë për komunitete kafshësh të egra si ujç, arinj, macet e egra, dhitë e egra dhe komunitetet e zogjve karakteristikë të shoqëruar me pyje të virgjëra. Shqipëria është një urë kalimi e rëndësishme për migrimin e zogjve, lakuriqëve dhe insekteve. Rrezikohen të zhduken rreth 91 specie në Shqipëri. Llojet kryesore të ekosistemeve dhe habitateve të dëmtuara përfshijnë dunat ranore, deltat e lumenjve, pyjet aluvionale, lagunat e brendshme, liqenet kontinentale, gëmushat mesdhetare, lëndinat alpine, liqenet kontinentale dhe glaciale, si dhe pyjet gjethegjërë dhe halore. Sistemi i lagunave bregdetare, në veçanti, është një nga komplekset më të rëndësishme të rajonit mesdhetar dhe është i rrezikuar nga rritja e aktivitetit njerëzor, përfshi turizmin dhe vendbanimet. Edhe habitatet marine janë të rrezikuara, sidomos nga pakësimi i habitateve dhe gjuetia ilegale sportive. Përpjekjet për përmirësimin e biodiversitetit pengohen nga interesi në rënie i popullatës për burimet natyrore të Shqipërisë.

Nëse menaxhohen mirë, këto zona paraqesin një potencial të madh për të siguruar të dhëna nga turizmi dhe argëtimet e tjera dhe janë në gjendje të ofrojnë shërbime të ekosistemit. Për të ruajtur qëndrueshmëri në përdorimin e burimeve natyrore, Qeveria duhet: a) të zhvillojë dhe zbatojë politika që synojnë menaxhim më të mirë të ujëmbledhësve nëpërmjet lehtësimit të menaxhimit në nivel fshati të kullotave malore dhe pyjeve; b) të sigurojë shfrytëzim afatgjatë të qëndrueshëm të burimeve ujore midis kërkesave konkurruese; dhe c) të zhvillojë dhe zbatojë politika të monitorimit dhe vëzhgimit të burimeve detare dhe ujërave të brendshëm. Rreth 6% e territorit të vendit, pra 58 zona, janë shpallur zona të mbrojtura, sipas të njëjtave parime që janë aplikuar te rrjeti natyra 2000. Kjo është e krahaseshme me 18% të vendeve të BE-së. Aktualisht, zonat e mbrojtura janë përqendruar te habitatet pyjore. Janë shtuar edhe habitate të tjera bregdetare dhe ekziston një plan që zonat e mbrojtura të dyfishohen. Por studimet dhe zbatimi pengohen për shkak të mungesës së fondeve.

Burimet ujore të freskëta në Shqipëri do të jenë subjekt i kërkesave konkurruese në rritje nga konsumi familjar, përdorimi industrial, prodhimi i energjisë elektrike dhe ujitja në bujqësi. Disa liqene janë bërë problem, sepse janë shumë të ndotura. Për të siguruar përdorimin racional të ujërave të freskëta të vendit dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve detare dhe të ujërave të ëmbla të peshkimit, duhet hartuar një strategji për burimet ujore. Rritja e peshkut është e zakonshme duke krijuar disa sfida për burimet ujore, sidomos në lagunat bregdetare dhe liqenet malore që kanë ekosisteme të rëndësishme, por të brishta dhe disa specie shumë të rralla. Sektori i peshkimit është gjithashtu i dobët, ku ligjet pothuaj mungojnë duke bërë që të zbatohen metoda joefikase peshkimi të cilat e dëmtojnë peshkun ekzistues.

Shqipëria ka një trashëgimi kulturore të pasur. Ajo është e mbrojtur me ligj, por zbatimi i ligjit nuk është i mundur, sepse nuk merr parasysh rrezikun e dëmtimit nga faktorë natyrorë siç janë përmbytjet, erozioni dhe afërsia me ndotjet industriale, të monumenteve. Pavarësisht nga këto probleme, Shqipëria mund ta shfrytëzojë më mirë trashëgiminë e saj kulturore si bazë për ta nxitur zhvillimin e zonave rurale dhe të vendit në përgjithësi. Ekzistojnë mundësi për hartimin e projekteve të ndryshme në të cilat trashëgimia kulturore dhe natyrore e kombinuar me aktivitete të tjera, mund të ofrojë premisa për një zhvillim më të shpejtë ekonomik. Aktivitete të tilla do të mbështeten me masa për zhvillimin rural.

I.4 Cilësia e jetës në zonat rurale

Ndërsa bujqësia në zonat rurale do të vazhdojë të luajë një rol dominant, veçanërisht si i vetmi burim punësimi, bizneset rurale jobujqësore duhet që të përmirësojnë mundësitë e sigurimit të të ardhurave, të ndikojnë në uljen e papunësisë dhe reduktojnë emigracionin. Zhvillimi i aktiviteteve me

karakter jobujqësor në zonat rurale, është minimal dhe ka natyrë informale dhe ka më pak rritje se në zonat urbane. Ai kufizohet në ndërtimet e dorës së dytë (të cilësisë së ulët), shërbime të vogla teknike dhe personale, si dhe tregti e vogël.

Dërgesat mund të shërbejnë si mjet për të nisur një investim në zonat rurale, por ato duhen mbështetur me shërbime financiare, nëse duam të kemi një zhvillim të qëndrueshëm. Mbështetja nga ana e qeverisë përfshin iniciativa për hapjen dhe rritjen e një aktiviteti në zonat rurale, ku bëjnë pjesë edhe skemat konkurruese të granteve, me një ndjenjë të fortë pronësie lokale. Do të sigurohen fonde për kurse profesionale sidomos për krijimin e aftësive për biznes, për teknologjinë e informacionit dhe për sistemet e informacionit për tregun. Konsolidimi i arritjeve të kohëve të fundit në tregjet e pronave dhe rregulloret e shkëmbimeve tregtare ndihmojnë në nxitjen e ndërmarrjeve jobujqësore.

Veprimtaritë jobujqësore në një fermë përfaqësojnë një burim të rëndësishëm të ardhurash shtesë për familjet rurale që janë aktive në fushën e bujqësisë. Veprimtari të tilla kanë nevojë për një bazë ligjore në një udhëzim të ri mbi veprimtari të tjera në ferma dhe mbështetje nga programet e zhvillimit rural mbi veprimtaritë në ferma.

Turizmi i huaj duhet të luajë një rol të veçantë në bizneset jobujqësore, sidomos në zonat malore dhe bregdetare, si dhe liqenet e pjesës juglindore dhe veriore ofrojnë disa mundësi. Por ka probleme që lidhen me kushtet e vështira fizike, ekosistemet e brishta dhe mungesën e aksesit, këto zona kanë potencial për të qenë destinacion tërheqës për disa turistë. Qeveria është angazhuar për reduktimin e ndotjes dhe mbrojtjen e mjedisit. Ndërtime të paplanifikuara, shpesh të shoqëruara me investime afatshkurtra turistike, i kanë dëmtuar disa zona dhe duhen kontrolluar. Kjo kërkon një program për edukimin e publikut për më shumë ndërgjegjësim mbi vlerat e trashëgimisë natyrore dhe kulturore shqiptare, sidomos për zhvillimin e turizmit cilësor ndërkombëtar që është një nga tregjet që po rritet më shumë në arenën ndërkombëtare, si dhe tregu më fitimprurës për Shqipërinë. Kjo do të kërkojë investime publike për ndërtimin e një infrastrukture cilësore, sidomos për furnizimin me ujë dhe higjienën.

Shqipërisë mund t'i krijohen mundësi reale në zhvillimin e turizmit të fermave, e cila mund të zhvillohet kryesisht mbi format e tjera të turizmit apo në atë malore, përreth liqeneve dhe rajoneve bregdetare. Turizmi i fermave mund të jetë një burim tjetër të ardhurash të rëndësishme për fermat dhe baza për zhvillimin e zonave më pak të zhvilluara, si rajonet malore. Mundësi tjetër është edhe zhvillimi i turizmit të fermave i kombinuar me bujqësinë organike. Fermat që janë aktive në fushën e turizmit, mund t'i ofrojnë tregut turistik turizmin e fermave ekologjike, si një mundësi e re që po bëhet popullore në këtë fushë.

Disa ferma, përreth qytetit të Tiranës, mund të orientohen drejt fermave të hapura që mund të vizitohen nga qytetarët, të cilët mund të qëndrojnë një ditë, të blenë produkte, të konsumojnë diçka dhe të mësojnë mbi jetën në fermë. Zhvillimi i agroturizmit, fermave të hapura të cilat ofrojnë shërbime të lidhura me to, duhet të mbështeten fuqimisht nëpërmjet politikave të zhvillimit rural.

Shqipëria është një vend që prodhon rrush dhe fruta të një cilësie të mirë që mund të shiten më shumë në "rrugët e vreshtave dhe frutave". Këto rrugë mund të ndërtohen në bashkëpunim me komunitetin lokal dhe të mbështeten nga programet e zhvillimit rural dhe rajonal. Në këto rrugë, mund të zhvillohen edhe aktivitete të tjera turistike të shoqëruara me investime të reja në infrastrukturë.

Mungesa e vazhdueshme e financimeve për investime në sektorin rural, përbën një pengesë themelore për zhvillimin rural në Shqipëri. Shkaqet për këtë janë: a) kostot e larta të transaksioneve dhe risqet e mëdha që mbart financimi rural; b) informacioni jo i plotë mbi klientët potencialë dhe mundësitë për huadhënie në zonat rurale; dhe c) një kuadër i varfër ligjor dhe institucional për transaksione të sigurta. Këto pengesa i kanë mbajtur bankat komerciale të instaluara në qendrat urbane dhe fokusimin e tyre në financimin urban, duke ngadalësuar kështu, zhvillimin e shërbimeve financiare dhe agjentëve financiarë. Për rregullimin e këtij problemi janë ndërmarrë një sërë veprimtarish. Projektet e mëparshme janë fokusuar te fondet e kredisë së fshatit, ndërsa tani po kompletohen me përpjekje të përqendruara për të zhvilluar një sistem kombëtar të shoqatave të kursim kredisë, të cilat do të mundësojnë depozitimin e kursimeve apo edhe shërbimet e huadhënies. Këto shoqata janë duke u shtrirë, por ka disa kufizime në shpejtësinë e shtrirjes së tyre duke e ruajtur cilësinë e shërbimeve. Paralel me zhvillimin e një sistemi mbarëkombëtar të institucioneve të mikrokredisë, inkurajuese duket që të jenë edhe disa sinjale të vogla që tregojnë se sektori bankar tregtar po fillon të shtrihet përtej bazës së tij aktuale urbane, si pjesë e shtrirjes së financimeve në të gjithë vendin. Strategjia e Zhvillimit Rural synon të ndihmojë sipërmarrjen private për të bërë

aplikime të mira në bankë, por nuk synon të ngre fonde shtetërore (p.sh. grante, banka rurale).

I.5 Zhvillimi rural i mbështetur në iniciativën lokale

Shqipëria ka siguruar eksperiencën të rëndësishme në mobilizimin e komuniteteve lokale kryesisht nëpërmjet programeve të financuara nga donatorë ndërkombëtarë. Përfitimi kryesor nga programet ishte që komuniteti ishte i përfshirë në të gjithë ciklin e projektit dhe projektet zgjidhen nga vetë ata. Në përgjithësi, rezultatet praktike nga realizimi i tyre i bënë ato më tërheqëse për popullsinë lokale. Por sipas një vlerësimi të kohëve të fundit bërë nga MAF–UNDP-ja projekti i “Zhvillimit të qëndrueshëm rural” përcaktoi një sërë nevojash ku përfshihen: trajnime për të gjithë anëtarët e grupet e veprimtari lokal (LAG); përmirësimin e bashkëpunimit midis përfituesve; përpjekje afatgjata për t'i ndryshuar praktikën lokale dhe praktikën e menaxhimit të burimeve natyrore; menaxhim më i mirë nga LAG i rrjeteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

II. QËLLIMI, PRIORITETET STRATEGJIKË DHE SYNIMET

II.1 Qëllimi i Strategjisë

Qëllimi i Strategjisë është që të shërbejë si një bazë kombëtare, për të cilën është rënë dakord dhe që përshtatet me politikën qeveritare për zhvillim dhe më pas zbatimin e planeve për zhvillimin rural të rajoneve dhe nënrajoneve të Shqipërisë për të stimuluar qëndrimin dhe rikthimin në zonat rurale. Zbatimi në të gjitha zonat rurale të Shqipërisë i masave që mbështesin zhvillimin rural.

Kjo Strategji bazohet te direktivat e Komunitetit Europian për Zhvillimin Rural 2007-2013, me qëllim realizimin e prioriteteve, të cilat do të shoqërohen me krijim të vendeve të reja të punës, rritje të prodhimit, si dhe zhvillim të qëndrueshëm, në mënyrë që të garantojë plotësimin e politikave qeveritare dhe europiane si kohezioni, mbrojtja e ambientit dhe koordinimi i fondeve të ndryshme të akorduara nga Buxheti i Shtetit dhe donatorë të tjerë.

II.2 Kohëzgjatja e Strategjisë

Propozohet që Strategjia Kombëtare Shqiptare për Zhvillimin Rural të zgjasë për një periudhë kohore 7-vjeçare. Viti 2007 duhet të përdoret për të zhvilluar planin e veprimeve për zhvillim rural, i cili do të përgatitet në bazë të kësaj Strategjie. Edhe zbatimi i disa aktiviteteve do të nisë në vitin 2007, mbi bazë pilotimi ose si veprimtari të rregullta. Pas përfundimit të vitit të parë të zbatimit të strategjisë, plani i veprimtari do të rishikohet.

II.3 Prioriteti strategjik

Prioriteti strategjik i Strategjisë së Zhvillimit Rural në Shqipëri është:

- Të kontribuojë për një zhvillim të barabartë të të gjitha rajoneve rurale në Shqipëri, të përmirësojë cilësinë e jetës në zonat rurale në Shqipëri dhe të reduktojë varfërinë.

II.4 Synimet

Synimet e Strategjisë së Zhvillimit Rural në Shqipëri janë:

1. Rritja e aftësisë konkurruese të sektorit bujqësor dhe agroushqimor duke mbështetur ristrukturimin dhe zhvillimin e aktiviteteve, të shtimit të vlerës (me qëllim rritjen e vlerës financiare të produkteve).

2. Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit duke menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme burimet natyrore në zonat rurale.

3. Përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale dhe nxitja e aktiviteteve të shumëllojshme ekonomike, nëpërmjet krijimit të vendeve të reja të punës.

4. Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për të planifikuar, menaxhuar dhe bashkërenduar efektivisht aktivitetet në mbështetje të zhvillimit rural.

Zbatimi i planit strategjik të zhvillimit rural do të kontribuojë në arritjen e qëllimit të strategjisë kombëtare nëpërmjet: arritjes dhe mbajtjes së një rritjeje ekonomike sipas principeve të një zhvillimi të qëndrueshëm, rritjes së potencialit njerëzor dhe arritjes së një niveli të nevojshëm punësimi, rritjes së të ardhurave, si dhe integritetit social, i cili siguron cilësi në rritje të nivelit të jetesës.

Të katër objektivat e planit strategjik kanë për qëllim përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale në zonat rurale. Orientimi drejt përmirësimit të konkurrueshmërisë së strukturës bujqësore dhe efijencës në treg, krijimi i vendeve të reja të punës, si dhe rritja e cilësisë së nivelit të jetesës do të jetë e evidente.

Realizimi i këtyre objektivave do të bëjë që njerëzit të vazhdojnë të jetojnë në zonat rurale, duke ruajtur strukturat e mbështetjes sociale dhe duke reduktuar rreziqet dhe koston publike që shoqërojnë migracionin në zonat urbane. Eksperiencën e vendeve të tjera tregon që zhvillimi rural

mund të përfitojë shumë nga lidhje më të fortë ekonomike, shoqërore dhe kulturore ndërmjet zonave rurale dhe urbane.

III. POLITIKAT DHE VEPRIMTARITË

Strategjia e zhvillimit rural ka nëntë politika kryesore të organizuara në katër akse, sipas modelit të udhëzuesit të BE-së për zhvillimin rural (RDR). Politika lidhet me zgjedhjen e masave që janë pjesë e RDR-së të BE-së. Secila politikë apo masë, përbëhet nga disa aktivitete.

AKSI I: KONKURRUESHMËRIA E SEKTORIT BUJQËSOR, AGROBIZNESIT DHE PYJEVE (60% e buxhetit total)

Analiza bazë: Duke u bazuar në nevojën e ristrukturimit të bujqësisë shqiptare dhe të sektorit të agropërpunimit që të jetë në gjendje të konkurrojë me BE-në, potencialin për përmirësim dhe ndikimin që do të ketë kjo mbi pjesën e popullsisë më të varfër dhe më të rrezikuar në Shqipëri, buxheti për aksin I ka dhe peshën më të madhe, ku 50% e buxhetit total të zhvillimit rural për vitin 2007-2013 i është alokuar këtij aksi. Ky aks përfshin mbështetje për prodhuesit dhe përpunuesit shqiptarë për t'iu përshtatur kërkesave të BE-së për standarde për sigurinë ushqimore dhe mirëqenien e kafshëve.

Masat dhe aktivitetet në aksin I kontribuojnë edhe tek objektivat e akseve të tjera, duke ndikuar në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mbrojtjen e mjedisit, nëpërmjet prodhimit dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore duke mbrojtur mjedisin dhe duke ulur ritmet e braktisjes së tokës.

Në vazhdimësi të politikave të aksit I, Shqipëria do të vazhdojë të zbatojë programin e punës së shërbimit këshillimor bujqësor (SHKB), të financuar nga shteti dhe pjesërisht nga aktivitetet tregtare. Aktivitetet e SHKB-së përcaktohen në Strategjinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe në programet vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Modernizimi dhe ristrukturimi i bujqësisë (55% të burimeve të aksit I)

Një pjesë e konsiderueshme e fondeve do të shkojë për modernizimin e ndërtesave dhe stallave të bagëtive në ferma, si dhe për ndërmarrjet e industrisë së përpunimit të ushqimit. Grupi i synuar për ndihmë janë fermerët e mesëm dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Gjithashtu do të mbështeten fermerët të specializuar, gjysmë autosuficientë, të cilët kanë mundësi ta rrisin aksesin e tyre në treg, mbas ndihmës. Ndihma do të shoqërohet me mbështetje për të siguruar shërbimet këshillimore, trajnime dhe mbështetje për bashkim në grupe prodhuesish, gjë që do të lehtësojë aksesin në treg. Shumë e rëndësishme është dhe mbështetja për sektorin e mishit dhe qumështit.

Do të nxitet konsolidimi i fermave nëpërmjet një sërë aktiviteteve nën aksin I, ku do të ketë edhe masa për inkurajimin e fermerëve dinamikë që të përdorin toka të cilat nuk janë shfrytëzuar sa duhet. Në mënyrë që të ketë mundësi të përdoret më me efektivitet mekanika bujqësore, të rriten rendimentet e prodhimit, të realizohet konsolidimi i tokës në parcela më të mëdha, dhe fermerët të paraqiten më të fuqishëm në treg. Mundësitë gjithnjë e më të mëdha për të siguruar të ardhura që bien nën këtë aks do të çojnë në rritjen e investimit në ferma dhe agropërpunimin.

Duhet të promovohet ngritja dhe funksionimi i shoqatave të fermerëve në formën e kooperativave në mënyrë që të realizohet konsolidimi i tokës, të bëhen më efektive, të ketë mundësi më të mëdha përdorimi i mekanizimit në parcela më të mëdha, në mënyrë që fermerët të paraqiten më të fuqishëm në treg. Ka një eksperiencë tashmë në lidhje me këtë fushë. Ka filluar një projekt në Lushnjë për konsolidimin federativ të fermerëve modern, si dhe dy projekte në Shkodër për krijimin e kooperativave.

Objektivi: Aktivitetet do të përqendrohen në përshtatjen e teknologjive sipas standardeve Europiane, në përmirësimin e konkurrencës në bujqësi dhe përmirësimin e situatës së të ardhurave për prodhuesit e produkteve bujqësore.

Aktivitetet:

- modernizimi i fermave bujqësore;
- ndihmë për fermerët për t'iu përshtatur kërkesave për standarde sipas legjislacionit të Komunitetit Europian;
- lindja e fermerëve të rinj;
- dalja e hershme në pension e fermerëve dhe punëtorëve të fermave, atje kur kjo është në favor të konsolidimit të këtyre fermave;
- përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës që lidhet me zhvillimin dhe adaptimin e bujqësisë dhe pyjeve.

Rritja e vlerës së shtuar dhe cilësisë në prodhim dhe përpunim (30% e burimeve të aksit I)

Shqipëria ka tradita në prodhimin e produkteve ushqimore, të cilat janë të njohura në tregjet Europiane – vaji i ullirit, varietetet e kosit, djathit të bardhë, mishit të vogël, molusqet etj. Suksesi në të ardhmen i zhvillimit të sektorit të përpunimit dhe aftësisë për të konkurruar me sektorin dinamik të prodhimit të produkteve ushqimore në Europë, varet në gatishmërinë e tij për t’u rritur nëpërmjet novacioneve. Afërsisht 30% e fondeve nën aksin I do të përdoren për novacione. Në këtë pikëpamje, do të nxitet bashkëpunimi ndërmjet shkencës, bujqësisë, përpunimit. Mbështetje do të ofrohet edhe për veprimtari që do kenë peshë në eksport dhe në sektorë të rëndësishëm për tregun e brendshëm, verërat, frutat, perimet, qumështi, mjalti, vajrat bimorë, foragjeret, industria përpunuese.

Një pjesë e rëndësishme e investimeve do të shkojë për përmbushjen e standardeve të komunitetit, sidomos në ndërtimin e ambienteve për mbarështim dhe instalimeve për pastrimin e ajrit, veçanërisht në zonat e rrezikuara nga nitratat. Në sektorin “qumësht dhe mish”, investimi do të shkojë për përmbushjen e kërkesave për higjienë. Në sektorin “pulari” do të vihet më shumë rëndësi njohjes së legjislacionit europian në lidhje me mirëqenien e kafshëve sidomos për kllloçkat. Programi do të synojë investime të rëndësishme, të cilat mund të arrihen vetëm me anën e kësaj mbështetje. Do të mbështetet edhe rritja e cilësisë së prodhimeve ushqimore në nivel ferme, ku do të jepet mbështetje për marketing dhe përmirësimin e ndërgjegjësimit të popullsisë mbi rëndësinë e rritjes së cilësisë së prodhimit lokal.

Objekti: Aktivitetet do të fokusohen në rritjen e efikasitetit, nxitjen e novacioneve, përmirësimin e cilësisë dhe mbrojtjen e mjedisit, në prodhimin, përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, ushqimore dhe pyjeve. Vëmendje e veçantë do të tregohet gjatë gjithë zinxhirit të prodhimit të ushqimeve, përdorimit të lëndës së parë si burim energjie i rinovueshëm dhe pjesëmarrjes në skemat për rritjen e cilësisë.

Aktivitetet:

- rritja e cilësisë së prodhimit bujqësor dhe të pyjeve;
- mbështetje për fermerët të cilët marrin pjesë në skemat e rritjes së cilësisë së ushqimeve;
- mbështetje për grupet e prodhuesve për informim dhe aktivitete promovuese për produktet nën skemat e cilësisë ushqimore.

Menaxhim i qëndrueshëm dhe efikas i pyjeve (10% e burimeve të aksit I)

Menaxherët e pyjeve kanë shumë pak rol në aksin I dhe do të mbështeten për investime, përmirësimin e vlerës ekonomike të pyjeve, të infrastrukturës së pyjeve dhe makinerive për lëndë drusore. Kjo mbështetje do të përmirësojë rendimentin në punë dhe kompetencat teknike.

Objekti: Ky prioritet synon rritjen e efikasitetit ekonomik të menaxhimit të pyjeve dhe vlerës ekonomike të tyre. Kujdes duhet t’i kushtohet aktiviteteve për përdorim më të efektshëm të potencialit ekonomik dhe energjetik të pyjeve, si dhe bashkëpunimit të pronarëve të pyjeve private. Aktivitetet janë në përputhje me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve.

Aktivitetet:

- rritja e vlerës ekonomike të pyjeve;
- mbështetje për ngritjen e grupeve të prodhuesve në sektorin e pyjeve.

Rritja e nivelit të kompetencave dhe punësimit (5% e burimeve të aksit I)

Një pjesë e fondeve të aksit I do të shkojë për trajnimin e fermerëve. I rëndësishëm është trajnimi i fermerëve të rinj dhe i prodhuesve të produkteve biologjike. Investimet në potencialin njerëzor janë pjesë e pandarë e procesit të përshtatjes me standardet e BE-së. Masat që synojnë zhvillimin e potencialit njerëzor do të përdoren për të krijuar aftësi drejtuese të fermat bujqësore. Gjithashtu, do të ofrohet mbështetje për trajnimin e fermerëve mbi teknikat e prodhimit organik, marketingun dhe bashkëpunimit. Si dhe do të mbështetë fermerët aktiv të komunitetit rural, por pa i dhënë rol privilegjuar në zhvillimin rural.

Objekti: Aktivitetet do të kontribuojnë në rritjen e kompetencave profesionale të fermerëve dhe shoqatave private të pyjeve, si dhe të të punësuarve në industrinë e përpunimit të ushqimit.

Aktivitetet:

- Trajnime profesionale dhe aktivitete informuese

AKSI II: RRUAJTJA E PEIZAZHIT KULTUROR DHE MBROJTJA E MJEDISIT
(10% e buxhetit total)

Analizat bazë: Shqipëria ka burime natyrore të virgjëra dhe të shumëllojshme. Veprimtaria bujqësore dhe pyjet janë relativisht të zhvilluara dhe në mbrojtje të mjedisit, kështu fermerët janë të motivuar të përfitojnë nga roli i tyre shumëfunksional, duke e përdorur peizazhin për argëtim dhe për

prodhimin e ushqimit. Qëllimi i dytë lidhet me zhvillimin e metodave bujqësore në përputhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, kompensimin e prodhuesve të zonave malore për ta mbajtur tokën në kushte të mira dhe për ruajtjen e peizazheve kulturore të rëndësishme. Qëllimi është kontribui në përmbushjen e prioritetit Strategjik europian: “Përmirësimi i mjedisit në fshat”. Buxheti për këtë aks do të jetë 10%.

Masat e aksit II nuk mund t’i japin zgjidhje problemeve që lidhen me ruajtjen e mjedisit dhe peizazhit. Strategjia bazohet në një metodë të balancuar dhe të integruar, ku ruajtja e peizazhit dhe mjedisit është prioritet për masat, nën akset e tjera. Për parandalimin e ndotjes me nitrat me origjinë bujqësore, janë të nevojshme investimet për zhvillimin e produkteve organike dhe blerjen e pajisjeve të nevojshme për punimin e tokës, gjë të cilën fermerët do të mund ta realizojnë nëpërmjet mbështetjes nga aksi I.

Të gjitha këto aktivitete shtojnë vlerën e sektorit bujqësor duke e bërë atë ultifunksional. Gjithashtu, ato kontribuojnë në rritjen e të ardhurave të balancuara të fermave bujqësore dhe përmirësojnë mjedisin. Ato kontribuojnë për rritjen e cilësisë së jetës në fshat dhe në zonat e tjera.

Ruajtja e peizazhit në zonat më pak të favorizuara (rreth 10% e burimeve të aksit II)

Mbështetja e aktiviteteve që lidhen me përdorimin e tokës bujqësore në zonat malore dhe respektin për mjedisin në këto zona, që do ta bëjë të mundur reduktimin e braktisjes së këtyre zonave. Planifikohet që 35% e buxhetit të aksit II të kalohet për mbështetjen e fermerëve të zonave malore.

Objekti: Menaxhimi i bujqësisë në rajonet me disavantazhe natyrore (malore, të pjerrëta, që përmblyhen, rrëshqitëse dhe që përshkohen nga erëra të forta), ku futja e teknologjive të njohura është e pamundur. Në këto zona prodhimi është ekstensiv dhe cilësia është larg prodhimeve të zonave fushore. Ekonomia prodhuese në këto zona është shumë e dobët. Në mënyrë indirekte, prioritet për këto zona janë menaxhimi i mjedisit rural dhe vendbanimi i zonave ku është braktisur aktiviteti bujqësor duke bërë të mundur vënien në punë të 300 000 hektarëve .

Aktivitetet:

Pagesa kompensuese për zonat me disavantazhe natyrore.

Praktikave bujqësore për mbrojtjen e mjedisit (rreth 90% e burimeve të aksit II)

Zgjidhja e problemeve kryesore do të shoqërohet me: ruajtjen dhe rivendosjen e diversitetit biologjik dhe gjenetik, përmirësimin e cilësisë së ujit, mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe degradimi, promovimi i planifikimit ekologjik, identifikimin dhe menaxhimin e habitateve të vlefshme dhe karakteristikave të mjedisit, ruajtjen e trashëgimisë kulturore, kryerjen e ciklit të rotacionit të drithërave, parandalimin e braktisjes së kullotave dhe lëndinave në zonat malore, janë qëllimet kryesore të Qeverisë. Një nga aktivitetet kryesore të programit është ruajtja e fermave bujqësore me vlera të mëdha natyrore, e cila sipas disa vlerësimeve paraprake (në përputhje me përcaktimin e Agjencisë Europiane të Mjedisit) zë 20% të tokës bujqësore në Shqipëri. Pjesa tjetër e aktiviteteve të NAEP-së lidhet me prodhimet organike të mjedisit. Është planifikuar që 40% e fondeve të aksit II të shkojnë për aktivitetet e NAEP-së.

Edhe përpunimi i mëtejshëm i planeve menaxhuese të Natura 2000 do të mbështeten nga aksi II. Në Natura 2000 dhe në zonat me vlerë të lartë natyrore është e rëndësishme të adaptohen praktika bujqësore dhe të evitohen teknologjitë të cilat shkaktojnë zhdukje të padëshiruara të kafshët dhe speciet bimore dhe zhdukjen e habitateve të tyre. Masat për forcimin e zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë dhe pylltarisë në formën e masave agroambientale në zonat e pafavorizuara, do të kontribuojnë thelbësisht në arritjen e objektivave të Natura 2000. Disa masa agromjedisore do të orientohen drejt zbatimit të kërkesave për arritjen e objektivave për ruajtjen e biodiversitetit dhe habitateve, është planifikuar që në periudhën 2009-2013 do të kompensohen aktivitetet që lidhen me ruajtjen e habitateve dhe specieve, të zakonshme për zonat kryesore të populluara nga zogjtë. Ato do të zgjerohen gradualisht duke përfshirë edhe aktivitetet që synojnë ruajtjen e habitateve të përcaktuara në përputhje me direktivat për habitatet.

Pyjet në Shqipëri menaxhohen gjerësisht dhe janë përgjithësisht të shëndetshme. Për rrjedhojë, nuk është e nevojshme të përcaktohen fonde të veçanta për pyjet nën aksin II. Në aksin I do të planifikohet një lloj mbështetje për pyjet, e cila do të menaxhohet në mënyrë që modernizimi të mos dëmtojë mjedisin.

Masat agromjedisore kanë për qëllim reduktimin e ndikimit të substancave në mjedis, rritjen e bujqësisë organike, reduktimin e burimeve të mundshme të ndotjes, reduktimin e erozionit dhe ruajtjen e biodiversitetit.

Objekti: Të gjitha masat agromjedisore synojnë përmirësimin e burimeve natyrore: toka, uji dhe ajri. Grupi i parë i aktiviteteve ka për qëllim prezantimin e praktikave bujqësore të përparuara që përmirësojnë kushtet mjedisore duke ulur përdorimin e substancave kimike, duke i futur në ciklin e lëndëve ushqyese bujqësore, duke futur prodhimet e kontrolluara dhe organike dhe duke parandaluar degradimin e vlerave ushqyese të tokës. Fokusi është mbrojtja biologjike e bimëve, qarkullimi i prodhimit bujqësor, si dhe reduktimi i erozionit për shkak të kullimit. Grupi i dytë i aktiviteteve ka për qëllim që fermat të praktikojnë bujqësinë tradicionale që ruan tiparet e veçanta shqiptare, siç janë zonat me shumëllojshmëri të kulturave bujqësore, habitateve livadhore (p.sh. kënetat me ujë dhe ato karstike) maleve dhe pemëve me trungje të larta. Ky grup aktiviteteve është mundësia më e mirë për zbatimin e Natura 2000, si dhe ruajtjen e karakteristikave të peizazhit natyror shqiptar. Metodot e bujqësisë tradicionale luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e shumëllojshmërisë së specieve të kafshëve të egra dhe bimëve, zonave natyrore me vlerë të madhe, habitateve specifike dhe diversitetin ekzistues të mjedisit bujqësor. Këto aktivitete kanë për qëllim ruajtjen e varietetit autoktonë të bimëve dhe kafshëve shtëpiake. Grupi i tretë i masave agromjedisore ka për qëllim ruajtjen e bujqësisë në zonat e vështira; për këtë arsye, këto praktika duhet t'i përshtaten kërkesave të domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit

Përfituesit e skemës së pagesave agromjedisore, duhet të plotësojnë kërkesat e parashtruara nga udhëzimi (KE) No.1782/2003 dhe udhëzimi për kërkesat e detyruara për menaxhimin dhe për kushtet e mira bujqësore dhe mjedisore (OJ RS Nr 21/2005, 114/2005, 76/2006), si dhe të gjitha kushtet e përcaktuara në masat individuale agromjedisore dhe janë mbi kërkesat minimale të udhëzimeve përkatëse dhe kërkesa të tjera që lidhen me përdorimin e spërkatësve minerale dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Në vitin 2007, angazhimet për zbatimin e masave agromjedisore nën programin e zhvillimit ruralë për mbështetjen rurale 2004-2006, do të vazhdojnë në periudhën 2007-2013. Ndërkohë që disa nga masat e periudhës 2004-2013 të zbatimit të programit do të rishikohen, të tjera do të riformulohen apo edhe do të bëhen nga fillimi, përfituesit që kanë praktikuar masat agromjedisore gjatë 2004-200, duhet t'i zëvendësojnë ato me masat e 2007-2013. Rregullimet dhe ndryshimet e masave do të ndodhin kryesisht për shkak të përshtatjes me kërkesat dhe standarde të tjera europiane. Në këtë mënyrë, e gjithë skema agromjedisore do të formulohet në atë mënyrë që çdo masë do të përputhet me kërkesat dhe duke u bazuar në kushte të tjera, do të shkojë me tej. Kështu, në vitin 2007 do të nisin kontratat e reja pesëvjeçare për përfituesit aktualë të pagesave agromjedisore, si dhe pagesat e reja për ata që zbatojnë këto masa.

Aktivitetet:

- mbështetje e praktikave bujqësore që përmirësojnë situatën mjedisore;
- ruajtja e praktikave tradicionale bujqësore, si dhe mirëmbajtja e potencialeve gjenetike;
- ruajtja e një bujqësie të qëndrueshme në zonat e mbrojtura.

AKSI III: PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË JETËS NË ZONAT RURALE DHE PROMOVIMI I DIVERSIFIKIMIT (30% e buxhetit total)

Analiza bazë: Strategjia e Zhvillimit Rural ka për qëllim krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat rurale. Ky qëllim do të kontribuojë në arritjen e prioritetit të tretë strategjik të Komunitetit që është "përmirësimi i kushteve të jetesës në zonat rurale dhe promovimi i shumëllojshmërisë së ekonomisë rurale". Ky aks do të marrë 40% të fondeve të zhvillimit rural. Strategjia për përmirësimin e këtij qëllimi bazohet në pikat e forta dhe të dobëta të zonave rurale, si dhe në problemet dhe avantazhet e tyre të identifikuar në analizë.

Zonat rurale kanë burime jashtë sektorit agrar, të cilat kanë potencial për zhvillim: një natyrë të pasur, të shumëllojshme dhe të mbrojtur, shumëllojshmëri komunitetesh rurale, tradita të pasura historike dhe kulturore; sidoqoftë, ato kanë nevojë për mbështetje për të kapërcyer prapambetjen në zhvillimin e tyre dhe që të mund t'i përshtaten konditave social-ekonomike në ndryshim.

Krijimi i mundësive për punësim në zonat rurale (20% të burimeve të aksit III)

Modernizimi dhe ristrukturimi i bujqësisë do të shkaktojë reduktimin e punësimit në bujqësi, gjë që paracakton nevojën e diversifikimit të aktiviteteve ekonomike për të krijuar kushtet për punësim me kohë të plotë apo fleksibël të fuqisë punëtore dhe për përmirësimin e të ardhurave. Krijimi i vendeve të punës në zonat rurale jashtë sektorit bujqësor do të bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm në të ardhmen. Shumica e këtyre vendeve të punës do të krijohen nga ndërmarrjet familjare apo bizneset e vogla, me aktivitete të cilat plotësojnë sektorin e bujqësisë (p.sh. turizmi, përpunimi dhe zejtaria

lokale, kultivimi i bletarisë). Turizmi dhe ambientet për kalimin e kohës së lirë do të përfitojnë për shkak të mbështetjes publike për krijimin e qendrave të informacionit dhe infrastrukturës, e cila do të bëjë të mundur aksesin në bukuritë e natyrës. Prioritet do t'i jepet inkurajimit të fuqisë investuese të popullsisë lokale dhe sidomos të grave dhe të rinjve.

Objekti: Synimi është rritja e potencialit për biznes në zonat rurale me anën e diversifikimit të fermave bujqësore në aktivitete jobujqësore, si dhe duke promovuar krijimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla. Mbështetja do të synojë në zhvillimin e ndërmarrjeve bazuar në avantazhet konkurruese që ka fshati (njohuritë tradicionale, fuqinë punëtore, lëndën e parë dhe kushtet e punës). Mbështetja për formimin profesional dhe aktivitetet informuese do të fokusohet te faktorët ekonomikë dhe banorët e tjerë të zonave rurale që veprojnë në fushat e mbuluara nga aksi III.

Aktivitetet:

- mbështetje për krijimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve bazuar në fuqinë konkurruese të zonave rurale;

- mbështetje për diversifikimin e fermave bujqësore;

- trajnim specifik dhe veprimtari informuese e aktorëve ekonomikë në zonat rurale.

Përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale (80% e burimeve të aksit III)

Sigurimi i infrastrukturës së duhur ose rinovimi i rrjeteve ekzistuese është në favor të aksesit në të gjithë territorin, si rrjedhojë stimulon rritjen ekonomike të komuniteteve rurale dhe tërheqjes së investimeve. Rrjetet e amortizuara të furnizimit me ujë duhen përmirësuar dhe higjiena e cila është e kufizuar në këto zona. Futja e teknologjisë së informacionit në zonat rurale është, gjithashtu shumë i rëndësishëm.

Ruajtja e trashëgimisë historike dhe kulturore e zonave rurale është e rëndësishme për ruajtjen e identitetit të tyre të vërtetë. Kjo e bën ringjalljen dhe mbrojtjen e trashëgimisë rurale pjesë të pandarë të politikës së zhvillimit rural. Mbrojtja e kësaj trashëgimie do të ketë përfitime ekonomike nga zhvillimi i turizmit

Objekti: Brenda kuadrit të këtij objekti prioritet do të jenë: infrastruktura bazë rurale, rigjallërimi i fshatit, rinovimi i ndërtesave për përdorime të ndryshme, shtrirja dhe përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikacionit lokal, turizmi dhe infrastruktura të tjera, sigurimi i mundësive për kryerjen e aktiviteteve të gjithanshme, si dhe rigjallërimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Këto prioritetet do të kenë për qëllim krijimin e shërbimeve të përshtatshme për ndërmarrjet dhe banorët e fshatit.

Aktivitetet:

- rinovimi dhe zhvillimi i fshatit, përfshi edhe rrugët lokale, furnizimin me ujë dhe higjienën;

- mbështetje për ruajtjen dhe rritjen e vlerave të trashëguara;

- shërbime bazë për ndërmarrjet dhe popullsinë e fshatit.

AKSI IV: PJESËMARRJA NË ZHVILLIMIN RURAL

Zbatimi i politikave të zhvillimit rural pas 2007-s, do të prezantojë metodën LEADER, si një instrument për një qeverisje të decentralizuar dhe zhvillimi rural të integruar. Në periudhën e para pranimit, MBUMK-ja do të ngrihet mbi eksperiencën ekzistuese të metodës LEADER, nga MADA, FZSH-ja dhe aktivitete planifikuese lokale. Mbështetja nga donatorët e ndryshëm do të shtrihet më tej duke replikuar këto aktivitete dhe projekte, të cilat kanë për synim krijimin e kapaciteteve për zbatimin e metodës LEADER. Në përputhje me praktikën e BE-së, të gjitha financimet rurale duhet të kenë një dimension mbi bazë komunitare. 5% e financimeve të zhvillimit rural do të alokohen veçanërisht për projekte të cilat ndjekin praktikën me bazë komunitare.

Nuk mund të ketë arritje të qëllimeve të politikës së zhvillimit rural pa përfshirjen dhe pjesëmarrjen e vërtetë të popullsisë lokale, pa krijimin e kapaciteteve lokale, pa informimin dhe trajnimin e popullsisë lokale në mënyrë që të mund të formulohet dhe vënë në zbatim strategjitë lokale të zhvillimit. Inkurajimi i dialogut dhe bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm lokal të përfshirë në zhvillimin rural është një hap i rëndësishëm në forcimin e shoqërisë civile dhe krijimin e partneriteteve në nivel lokal.

Prandaj është e domosdoshme të mbështeten përpjekjet në të ardhmen për ngritjen e kapaciteteve të zonave rurale në:

- hartimin e strategjive të zhvillimit lokal;

- ngritjen dhe forcimin e grupeve të veprimit lokalë (LAG);

- vënien në zbatim të strategjive të zhvillimit lokal;

- promovimin e bashkëpunimit ndërmjet vendeve të rajonit, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Gjatë vitit të parë, është e rëndësishme që Shqipëria të fokusohet në aktivitete që lidhen me rritjen e aftësive dhe hartimin e strategjive të zhvillimit paralel me krijimin dhe fuqizimin e grupeve të veprimit lokal. Për këtë duhen shfrytëzuar mundësitë që krijohen për rritjen e aftësive dhe rigjallërimin e territoreve.

Zhvillimi i kapaciteteve lokale dhe përmirësimi i vetëqeverisjes lokale në Shqipëri do të nxisë vënien në zbatim të strategjive të zhvillimit lokal nëpërmjet grupeve të veprimit lokalë ekzistues.

Për shkak të kapacitetit lokal të kufizuar për krijimin e grupeve aktive lokale, aftësive të kufizuara drejtuese për strategjitë e zhvillimit për zonat rurale dhe aftësi të pamjaftueshme për bashkëpunim dhe krijimin e rrjeteve –sidomos jashtë komuniteteve rurale, do të jepet më shumë mbështetje për masa dhe aktivitete që lidhen me krijimin e aftësive dhe trajnim për informimin në nivel lokal. Në përcaktimin e peshës financiare të aktiviteteve të ndryshme dhe masave të mbështetura nga ky aks, duhet t'i kushtohet vëmendje menaxhimit dhe zbatimit të strategjive lokale të zhvillimit.

Grupet aktive lokale në Shqipëri duhet të jenë aktive në të gjitha zonat rurale që nënkupton se, prioritetet lokale do të realizohen nëpërmjet masave dhe aktiviteteve nën aksin III, duke siguruar më shumë akses nën masat e aksit I dhe nëpërmjet masave të aksit II, atje ku do të jenë prioritetet për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe tokës.

IV. RURAL “PROOFING” DHE RAPORTIMI PËR PUBLIKUN E GJERË MBI INVESTIMET DHE SHËRBIMET

Të katër akset përshkruajnë strategjinë e zhvillimit rural e cila do të financohet nëpërmjet koordinimit të programeve për zhvillimin rural. Strategjia kombëtare e zhvillimit rural mbulon, gjithashtu dhe ndikimin rural të shërbimeve dhe investimeve të tjera publike duke përfshirë në veçanti; arsimin, shëndetësinë, mirëqenien shoqërore dhe infrastrukturën.

Ndikimi rural i këtyre aktiviteteve do të monitorohet nëpërmjet sistemit të raportimit “rural proofing” në të cilin çdo Ministri do t’i kërkohej të prodhojë një raport periodik mbi ndikimin rural të aktiviteteve të saj. Këto raporte do të përpilohen sipas këtij modeli: a) përshkrimi i mënyrës së shpenzimeve, duke krahasuar zonat rurale dhe urbane; b) shpjegime mbi çdo informacion të ri; dhe c) metoda se si pasqyrohen ndryshimet urbane/rurale në praktikën e menaxhimit.

Raportet vjetore të raportimit për **arsimin** dhe **shëndetësinë** do të kenë të njëjtin format. Ato do të raportojnë për shpërndarjen gjeografike të shpenzimeve për arsimin për person, për ato zëra që mund t’u kalohen rajoneve. Raporti duhet të analizojë edhe sfidat me të cilat përballet arsimi në zonat rurale dhe si veprohet për t’i përballuar këto sfida.

Shpenzimet shtetërore për **ndihmën sociale** përfshijnë pagesat e papunësisë dhe të aftësisë së kufizuar. MOLSAEO do të përgatisë një raport vjetor që do tregojë shpërndarjen gjeografike të pagesave duke e lidhur këtë me shpërndarjen e popullsisë. Ky raport duhet të shpjegojë skemat e reja dhe si menaxhohen në praktikë ndryshimet rajonale.

Investimet në **infrastrukturë** në zonat rurale menaxhohen kryesisht nga MPPTT-ja dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Këto dy institucione do të përdorin sistemet e tyre të menaxhimit për formulimin e raporteve vjetore që do përshkruajnë vendin ku zhvillohen aktivitetet dhe do të analizojnë numrin e aktiviteteve që organizohen në zonat rurale. Raporti vjetor rural do të informojë edhe për ndikimin e praktikave menaxhuese mbi sasinë e aktiviteteve rurale dhe, nëse nevojiten praktika të veçanta që bëjnë të mundur që zonat rurale të përfitojnë një shumë të konsiderueshme për ta shpenzuar. Një analizë e tillë mund të përfshijë edhe vlerësimin e efikasitetit të shpenzimeve në zonat urbane dhe rurale.

V. MENAXHIMI DHE BUXHETI

V.1 Menaxhimi

Politika e zhvillimit rural përfaqëson shtyllën e dytë të politikës për bujqësinë në BE-së. Për rrjedhojë, në Shqipëri, ashtu, si dhe në vendet anëtare të BE-së, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) do të jetë ministria përgjegjëse për zhvillimin rural. MBUMK – ja do të jetë autoriteti kompetent që përgjigjet për dhënien dhe heqjen e akreditimit të agjencisë së pagesës.

Për të pasur një strukturë efikase, MBUMK-ja do të riorganizojë strukturën e saj të brendshme në atë mënyrë që të gjitha politikat e zhvillimit të përcaktohen nga një drejtori e vetme që përgjigjet për zhvillimin rural. Drejtoria që përgjigjet për zhvillimin rural nuk ka staf të mjaftueshëm kështu, që do t'i duhen punonjës të rinj (afërsisht 10 vetë). Rekrutimi i stafit të ri për drejtorinë e zhvillimit rural do të bëhet nga radhët e stafit ekzistues në MBUMK dhe në institucionet përkatëse ekzistuese në Shqipëri. Në bazë të udhëzuesit nr.1658 të Këshillit të BE-së, kjo drejtori do të emërohet si autoriteti drejtues për programet e zhvillimit rural.

Koordinimi në nivel strategjik është me shumë rëndësi për lidhjen reciproke ndërmjet objektivave të ndryshme dhe për rrjedhojë për të arritur një ndikim maksimal në zhvillimin social-ekonomik të vendit. Mekanizmi koordinues do të përgjigjet për mbikëqyrjen e programit të raportimit rural dhe për të siguruar paraqitjen nga ministrinë pjesëmarrëse të raportit vjetor të një standardi të pranueshëm. Mekanizmi koordinues do të ngrihet për ta bërë të mundur shpërndarjen e duhur të ndihmave të dhëna për zhvillimin rural. Ky mekanizëm do të jetë i veçantë nga institucionet përgjegjëse për menaxhimin dhe monitorimin e programit në Shqipëri.

Drejtoria e zhvillimit rural në MBUMK do të përgjigjet për të ofruar **shërbime sekretarie** për mekanizmin koordinues. Përgjegjësitë e sekretariatit do të përfshijnë mbajtjen e një baze të dhënash me informacion për zhvillimin rural. Informacioni duhet të jetë në dispozicion të publikut dhe do të jetë pjesë përbërëse e një raporti vjetor mbi gjendjen e zhvillimit rural në Shqipëri.

Grupi i punës ndërministror do të përgjigjet për koordinimin ndërministror në nivel strategjik dhe programi veprimesh. Grupi teknik ekzistues do të bëjë koordinimin e nevojshëm gjatë përgatitjes së tenderit, duke mundësuar lidhjen ndërmjet aktiviteteve.

Duke u bazuar në strategjinë ndërsektoriale të zhvillimit rural, do të hartohet programi operacional për zhvillimin rural (plani i veprimit të zhvillimit rural) për periudhën 2007-2013, i cili do të mbulojë të gjithë territorin shqiptar. Strategjia dhe plani i veprimeve do të plotësohen, nëse do të jetë e nevojshme, brenda periudhës shtatëvjeçare të programit. Çdo vit, do të njoftohet zhvillimi i tenderit vjetor.

Parashikohen dy faza për zbatimin e programeve të zhvillimit rural në Shqipëri:

- në tri vitet e para të programit, zbatimi do të bëhet duke shfrytëzuar institucionet dhe procedurat ekzistuese;

- pas tri viteve të para, do të nisë aktivitetin Agjencia Qendrore e Pagesave. Në këtë fazë, përgjegjësitë për zbatimin e politikave të zhvillimit rural do të transferohen gradualisht në kompetencë të Agjencisë së Pagesave.

Agjencia Qendrore e Pagesave do të krijohet si një strukturë e pavarur nën ombrellën e MBUMK-së dhe do të përgjigjet për zbatimin e zhvillimit rural, por për politikat e tregut në Shqipëri. Agjencia e Pagesave do të akreditohet edhe si Agjencia e vetme e Pagesave për mbështetjen nga BE-ja për periudhën para aderimit dhe më vonë për zbatimin e politikës CAP (mbi organizimin e tregjeve dhe zhvillimin rural) në Shqipëri. Agjencia Qendrore e Pagesave mund të zbatojë edhe politikat e zhvillimit rural të mbështetura nga donatorë të ndryshëm.

Agjencia e Pagesave do të ndjekë procedurat e përcaktuara në udhëzimet e këshillit të BE, si dhe të udhëzimeve të zbatimit. Kjo Agjenci do të përmbushë kërkesat e mëposhtme: a) ekzekutimin e pagesave dhe kontabilizimin; b) sistem për kontrollin e menaxhimin të brendshëm; c) paraqitje e qartë, e shpejtë, e detajuar dhe e vërtetuar e shpenzimeve dhe raporteve bankare; d) procedura prokurimi transparente dhe jodiskriminuese që parandalojnë konfliktin e interesave; dhe e) përputhje me të gjithë legjislacionin shqiptar për financat publike.

Agjencia Qendrore e Pagesave do t'iu kalojë disa aktivitete institucioneve të tjera ekzistuese që veprojnë në Shqipëri (si FSHZH, MADA), por kjo do të bëhet vetëm për ato aktivitete që nuk klasifikohen si aktivitetet bazë të Agjencisë së Pagesave. Këto institucione nuk do të akreditohen si agjenci pagesash dhe do të bashkëpunojnë me Agjencinë qendrore të Pagesave në bazë kontratash njëvjeçare. Agjencia Qendrore e Pagesave do të shfrytëzojë edhe shërbimet e disponueshme në nivel rajonal.

Për të qenë sa më efikase dhe me mbështetje financiare, disa nga institucionet dhe strukturat ekzistuese (si ZKR, disa zyra rajonale dhe lokale, struktura, institucione) do të jenë pjesë e strukturës së Agjencisë Qendrore të Pagesave. Sidoqoftë, Agjencia Qendrore e Pagesave deri në fund të vitit do të ketë 400 punonjës të përhershëm dhe kosto bazë për krijimin e saj do të jetë 8 milionë euro (pa investimet në bazë të të dhënave) për një periudhë kohore dhjetëvjeçare. Disa nga punonjësit do të

rekrutohen nga institucionet ekzistuese dhe kosto për krijimin e saj mund të bashkëfinancohet nga BE-ja dhe donatorë të tjerë. Agjencia e pagesave mund të fillojë të operojë brenda tri viteve dhe pasi nuk ka marrë akreditim të plotë. Në bazë të eksperiencës së vendeve anëtare të Bashkimit European, do të duhen nga shtatë deri në dhjetë vjet për akreditimin e plotë të Agjencisë së Pagesave. Në një periudhë dhjetëvjeçare, Agjencia Qendrore e Pagesave në Shqipëri, do të zbatojë plotësisht politikat e zhvillimit rural në Shqipëri edhe në rast se anëtarësimi në BE mund të vonohet.

Sipas praktikave të BE-së, grupi këshillues për përgatitjen e strategjisë do të bëhet **Rrjeti Kombëtar Rural**. Por, në të njëjtën kohë, Rrjeti Kombëtar Rural mund të emërohet si Komitet monitorues. Në këtë rrjet parashikohet pjesëmarrja e NGO-ve rajonale ose e rrjeteve kombëtare të organizatave jofitimprurëse, NGO-të që punojnë në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm lokal dhe rural, shoqatat e biznesit dhe degët e tyre, NGO-të për mbrojtjen e mjedisit, përfaqësues të mundësive të barabarta, autoritete bashkiake, përfaqësues të njësive administrative kombëtare, rajonale dhe lokale, si dhe shërbimeve të MBUMK-së dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Rezervave Ujore.

Funksionet kryesore të rrjetit kombëtar të zhvillimit rural do të jenë:

1. Lobimi në politikën qeveritare në interes të zonave rurale, duke përfshirë dhe raportet rurale “rural proofing”.

2. Sigurimin e informacionit për anëtarët e rrjetit, përfituesit e mundshëm për masat e zhvillimit rural.

3. Organizimi i seminareve trajnuese dhe ndihma nga ekspertët për zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve të rrjetit. Kontribut për krijimin dhe ngritja e kapacitetit të OJF-ve.

4. Nisja dhe ndërmjetësimi ndërmjet përfaqësuesve të organizatave të ndryshme, strukturave aktive të përfshira në zhvillimin rural dhe të autoriteteve kombëtare dhe lokale për dialog.

5. Forcimi dhe zgjerimi i rrjetit gjatë periudhës së veprimit të programit kombëtar të zhvillimit rural; organizimi i studimeve për qëllimet e programit.

6. Veprimtari të cilat nxisin pjesëmarrjen në Rrjetin European të Zhvillimit Rural.

V.2 Buxheti

Tabela 2 paraqet analizën e shtrirjes së aktiviteteve ekzistuese të zhvillimit rural në Shqipëri. Afërsisht 500 nga 1800 projekte të listuara në buxhetin e viti 2006 mund të klasifikohen rurale. Një numër programesh të rëndësishme (ku përfshihet infrastruktura e FSHZH-së dhe programet promocionale të Ministrisë së Ekonomisë) janë mbarëkombëtare dhe nuk mund të vendosen lehtësisht në zonat rurale dhe urbane. Analiza bën fjalë për rreth 7.4 bilionë lekë në vit të shpenzuara për zhvillimin rural. Rreth një e treta e shpenzimeve të përcaktuara për projektet rurale është për rrugët rurale dhe furnizimin me ujë të fshatit dhe menaxhohet nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, ku kontributi i donatorëve është vetëm 12%. Ujitja dhe kullimi zënë 25% të shpenzimeve për zhvillimin rural dhe donatorët mbulojnë 65% të financimit. Projektet mjedisore zënë 25% më shumë pak mbështetje nga donatorët. Shumica e financimeve shkojnë për higjienën në zonat rurale dhe pak për projektet mjedisore dhe nën SAPARD mund të klasifikohen si projekte të infrastrukturës rurale.

Tabela 2 Analiza e buxhetit të viti 2006 kundrejt masave të SAPARD (vlera në bilionë lekë)

Masa	Kategorizimi	Vendase	Donatorët	Totali	Ministritë
SAPARD					
Përpunimi, marketingu	Ndërtesa dhe pajisje	142	25	167	Bujq./Ekon
Investime në ferma	Ndërtesa, mall, marketing	68	538	606	Bujqësi
Infrastrukturë rurale	Rrugë, ujë, energji, ICT	2,277	307	2,583	Bujq./PP
Mjedisi	Sistemet e fermave, mbrojtja	5	1,553	1,558	Mjedisi
Burimet ujore	Ujitja, kullimi, peshkimi	594	1,103	1,696	Bujqësi
Kontrolli i cilësisë	Ushqimi, bimët, veterinaria, kufijtë	43	0	43	Bujqësi
Pylltaria	Pyjet, marketingu	221	148	369	Mjedisi
Diversifikimi	Përpunimi, shërbimet, turizmi	0	0	0	

Përmirësimi i tokës	Toka, ndarja e parcelave	44	0	44	Bujqësi
Regjistrat e tokës	Regjistrimi i tokës, konsolidimi	87	200	287	Bujqësi
Menaxhimi i fermës	Këshillim, makineri, lehtësim	0	0	0	
Rinovim i fshatit	Trashëgimia, qendrat komunitare	0	0	0	
Grupet e prodhuesve	Marketing i përbashkët	0	0	0	
Trajnim	Punët bujqësore, përpunimi, ekologjia	0	0	0	
TA	Menaxhim, ndërgjegjësim	0	0	0	
Totali		3,481	3,874	7,355	

Shpenzimet për zhvillimin rural mund të rriten në përputhje me totalin e investimeve publike. Me afrimin e Shqipërisë te normat e BE-së, do të rritet edhe pjesa e zhvillimit rural në investimet publike. Analiza makroekonomike tregon që shpenzimet kapitale shtetërore do të rriten nga 6% e GDP-së në 9% të GDP-së, që nëse kombinohet me rritjen vjetore të GDP-së prej 6%, do të arrijë në një rritje prej 46% të shpenzimeve shtetërore nga viti 2006 në 2009, e shprehur në çmime konstante. Kjo gjë do ta çojë shpenzimin total për zhvillimin rural në rreth 10.7 bilionë për të gjitha institucionet qeveritare, nëse zhvillimi rural do të ketë po atë pjesë që zotëron në totalin e shpenzimeve.

Në buxhetin e vitit 2007, MBUMK-ja menaxhon vetëm 359 milionë lekë nga shpenzimet për Zhvillimin Rural, e lidhur ngushtë me projektet e donatorëve në fushën e promovimit të ndërmarrjeve bujqësore. Kjo përbën më pak se 5% të buxhetit total. Kjo përqindje do të rritet gradualisht, me kanalizimin e mbështetjes së BE-së për zhvillimin rural nëpërmjet Agjencisë së Pagesave dhe ndërkohë që aktivitetet e financuara nga agjencitë vendase apo donatorët do ta kuptojnë vlerën e investimit nëpërmjet Agjencisë së Pagesave. Nëse Shqipëria do të marrë të njëjtin financim për frymë për zhvillimin rural edhe nën IPARD-në si nën SAPARD, shuma do të arrijë në 17 milionë euro në vit, ose rreth 2 bilionë lekë, që do të përbëjë rreth dy të tretat e rritjes së shpenzimeve për zhvillimin rural. E gjithë kjo rritje do të menaxhohet nëpërmjet RPA-së. Nëse e gjithë rritja për zhvillimin rural, do të menaxhohet nga MBUMK-ja, atëherë bëhet fjalë për 3.7 bilionë lekë, ose rreth 35% të financimit total për zhvillimin rural.

Tabela 3 tregon ndryshimet ndërmjet vitit 2006 dhe 2009, duke u bazuar në ruajtjen e një përqindjeje konstante të shpenzimeve publike të parashikuara dhe ndarjes së përqindjeve siç propozohen në strategji. Mendohet se këto përqindje do t'i aplikohen si pjesës së zhvillimit rural të menaxhuar nga MBUMK-ja dhe asaj të menaxhuar nga ministritë dhe agjencitë e tjera shtetërore. Tabela tregon se rritjet më të mëdha do të bëhen për të mbështetur vlerën e shtuar, marketingun dhe punësimin jashtë bujqësisë. Rritje të ndjeshme do të ketë edhe në mbështetje të modernizimit të fermave dhe infrastrukturës rurale. Reduktimi i shpenzimeve mjedisore në aksin 2 bëhet pjesërisht për shkak se shpenzimet e vitit 2006 mbulonin aktivitete të lidhura me kontrollin e ndotjes (duhet verifikuar!!fjalë). Për herë të parë, tri masa do të marrin fonde të konsiderueshme, nga të cilat mbështetja për punësimin jashtë bujqësisë do të jetë më e rëndësishmja.

Tabela 3 Buxheti i Zhvillimit Rural

	2006		2013			Minimumi i BE
	%	m lekë	m lekë	% of axis	% total	
Aksi 1						
Modernizimi i fermave	35.8%	2,633	4,675	55%	27.5%	
Vlera e shtuar/marketingu	2.9%	210	2,550	30%	15.0%	
Pyjet	5.0%	369	850	10%	5.0%	
Trajnim/shërbimi i këshillimit	0.0%	0	425	5%	2.5%	
Totali	43.7%	3,213	8,500		50.0%	10%
Aksi 2						
Zonat më pak të favorizuara	21.2%	1,558	170	10%	1.0%	
Agromjedisi dhe natura 2000	0.0%		1,530	90%	9.0%	

Totali	21.2%	1,558	1,700		10.0%	25%
Aksi 3						
Punësim jashtë fermës	0.0%	0	1,190	20%	7.0%	
Cilësia e jetës rurale/ Infrastruktura	35.1%	2,583	4,760	80%	28.0%	
Totali	35.1%	2,583	5,950		35.0%	5%
Aksi 4						
Pjesëmarrja në zhvillim		0	850		5.0%	
Totali	100.0%	7,355	17,000		100.0%	

Shënime: modernizimi i fermave – mbështetje për investime për t'i ndihmuar fermat ta përmirësojnë prodhimin dhe efikasitetin, të fusin praktika të reja, të zgjerojnë dhe konsolidojnë; vlera e shtuar dhe marketimi – mbështetje në ndihmë të fermerëve dhe grupeve të fermerëve për furnizimin e tregut të brendshëm dhe të jashtëm, përfshi edhe përmbushjen e standardeve të cilësisë; pyjet – mbështetje për investime për përmirësimin e cilësisë së menaxhimit të pyjeve; trajnimi dhe asistencë teknike – mbështetje për zhvillimin e aftësive të fermerët dhe për ata që punojnë në rrjetin e fermave; LFA – mbështetje për fermerët në zonat e pafavorizuara (përfshi dhe zonat malore); agromjedisi – pagesa për fermerët për t'i inkurajuar të menaxhojnë mjedisin; punësim jashtë fermave – mbështetje për nxitjen e investimeve jashtë fermave në zonat rurale, përfshi edhe ato në ferma dhe jashtë fermave; cilësia e jetës/infrastruktura rurale – grante për rrugët rurale, ujin dhe higjienën dhe për projekte të vogla komunitare.

Aktualisht, donatorët financojnë rreth 50% të aktiviteteve të zhvillimit rural. Përqindja e financimeve nga donatorët në totalin e investimeve publike do të bien dhe mendohet që kjo do të ndikojë në zhvillimin rural në proporcion me sektorët e tjerë. Shpërndarja e parashikuar e fondeve të IPARD-it dhe mbështetja e vazhdueshme për zhvillimin rural nga donatorë të tjerë kryesorë, mund ta mbrojë zhvillimin rural nga kjo rënie. Tabela 4 paraqet nivelin e financimeve të donatorëve për çdo politikë që ka strukturë të ngjashme me atë të shpenzimeve totale.

Tabela 3 Financimet e donatorëve

	Financimet e donatorëve			
	2006		2009	
Aksi 1	lekë	%	lekë	%
Modernizimi i fermave	1,641	70%	1,911	63.2%
Vlera e shtuar/marketimi	25	12%	177	10.7%
Pyjet	148	40%	199	36.3%
Trajnim/shërbime këshilluese		60%	149	54.2%
Totali				
Aksi 2				
Zona më pak të favourizuara	0	60%	60	54.2%
Agromjedisi dhe natura 2000	1,553	100%	892	90.1%
Totali				
Aksi 3				
Punësimi jashtë fermave	0	60%	417	54.2%

Cilësia e jetës në fshat/infrastruktura	307	12%	331	10.7%
Totali				
Aksi 4				
Pjesëmarrja		60.0%	298	54.2%
Totali	3,674	50.0%	4,434	40.3%

VI. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

VI.1 Agjencia e Pagesave

Aktivitetet e strategjisë së zhvillimit rural do të monitorohen nëpërmjet praktikave të aplikuara për programet e zhvillimit rural. Raportet vjetore të monitorimit do të formulohen në bazë të informacioneve të siguruar nga drejtuesit e projektit. Raportet vlerësuese do të formulohen para fillimit të programeve dhe në periudha kyçe të programit, zakonisht në mes dhe pas përfundimit të projektit.

Agjencia e Pagesave do të përgjigjet për sigurimin e raporteve të monitorimit dhe drejtorja e zhvillimit rural do të përgjigjet për miratimin e cilësisë së raporteve dhe formulimin e një përmbledhjeje të vetme të përmbledhur në një raport vjetor të monitorimit. Agjencia e Pagesave do të bëjë kontraktimin për vlerësimet, ndërsa këto të fundit do të kryhen nga organizata të pavarura, të tilla si firma konsulence ose akademike. Drejtorja e zhvillimit rural duhet të sigurohet që vlerësimet gjatë formulimit dhe rishikimit të politikave, të merren parasysh vlerësimet.

5. Treguesit

Indikatori	Parametrat vlerësues	Vlera bazë	Vlera e synuar në vitin 2013*	Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave
AKSI 1				
Rendimenti i punës në bujqësi	VBSH (Vlera bruto e shtuar në euro.) për fuqi punëtore	1700 euro (INSTAT, 2004)	2072 euro (+20%)	INSTAT
Madhësia e fermës	Madhësia mesatare për çdo fermë	1.1 ha (MBUMK-ja, vjetari statistikor)	1,98ha (+80%)	Instat, MBUMK
Rendimenti i punës në industrinë ushqimore	VBSH për punonjës	4547 euro (INSTAT, 2004)	4670 euro (+5%)	INSTAT
Niveli arsimor i fermerëve	Përqindja e fermerëve me arsim 9-vjeçar të përfunduar.	48% (MBUMK, vjetari statistikor)	57.6% (+20%)	MBUMK, Ministria e Arsimit?
Trajnime dhe arsimim në bujqësi	Përqindja e fermerëve me arsim primar dhe sekondar të përfunduar në bujqësi	48% Shërbimi i ekstensionit	58% (+20%)	Shërbimi i ekstensionit?
Kualifikimi i fermerëve	Përqindja e fermerëve me çdo lloj arsimimi për bujqësinë	Primary 17%, arsim i mesëm 31 (Shërbimi i ekstensionit)	+5%	Shërbimi i ekstensionit
AKSI 2				

Biodiversiteti	Përqindja e mbrojtur e tokës për shkak të specieve të veçanta të zogjve	Akoma e papërcaktuar! Ministria e Mjedisit	1% e territorit?	Ministria e Mjedisit
Tokat e kultivuara në zonat e mbrojtura	Përqindja e tokave të kultivuara në zonat e mbrojtura	6% (183.400ha) (Ministria e Mjedisit)	12% e totalit të tokës bujqësore (367,000ha)	Ministria e Mjedisit
Cilësia e ujit	Përqindja e tokës në zonat e mbrojtura nën ujë	1% (27.300ha) (Ministria e Mjedisit)	2% (54.600ha)	Ministria e Mjedisit
Angazhimi në bujqësinë organike	Përqindja e zonave me prodhime organike në khs me zonat e pafavorizuara	Më pak se 0.1%, MBUMK	Rreth 0.12%	MBUMK
Ndryshimet e klimës	Prodhimi i energjisë së rinovueshme në bujqësi dhe pylltari	13.2% e totalit të burimeve të energjisë (të dhëna vetëm nga 2001!!)??	14% (+5%)??	Ministria e Mjedisit
Tokë e kultivuar në zonat e pafavorizuara	Përqindja si pjesë e totalit të tokës bujqësore në zonat e pafavorizuara	Këto zona akoma nuk janë përcaktuar	Për herë të parë do të paraqiten në vitin 2010	MBUMK
Zona nën masa agromjedisore	Toka nën masat agromjedisore	1.200 ha (vlerësim i shoqatës së bujqësisë organike)	2000ha	MBUMK, Ministria e Mjedisit
AKSI 3				
Ferma me të ardhura dhe punësim në aktivitetet jobujqësore	Ferma me të ardhura dhe punësim në aktivitetet jobujqësore	8.9% (MBUMK, vjetari statistikor), 2005)	9.79% (+10%)	MBUMK, INSTAT
Punësimi në sektorin jobujqësor	Punësimi në sektorin sekondar dhe terciar (në %)	45% (INSTAT, 2005)	54% (+20%)	INSTAT
Zhvillimi ekonomik i sektorit jobujqësor	GVA në sektorin sekondar dhe terciar (në milion €)	4100 euro (INSTAT, 2004)	4387 euro (+7%)	INSTAT
Vetëpunësimi	Përqindja e vetëpunësimit në sektorin jobujqësor në punësimin total			MBUMK, INSTAT
Instalimi i internetit në zonat rurale	Përqindja e popullsisë me akses në Internet	0.9% (LSMS-INSTAT)	4.5% (+500%)	INSTAT
Zhvillimi i sektorit të shërbimeve	Përqindja e shërbimeve GVA (e totalit të GVA-së)	53.7% (INSTAT, 2004)	57.5% (+7%)	INSTAT
Arsimimi gjatë gjithë jetës	Përqindja e pjesëmarrësve të trajnuar të moshës 25-64	2% (vlerësim i MBUMK-së)	Në rritje	MBUMK Shërbimi i ekstensionit

* Vlerat e mësipërme janë të përafërta dhe do të korrigjohen nëse do të jetë e nevojshme.

EAA – Economic Accounts for Agriculture (Llogaritjet ekonomike për bujqësinë).

NA – National Accounts (Llogaritjet kombëtare).

AHS – Agricultural Holdings Structure (Struktura e fermave bujqësore).

VI.2 Përkufizimi i zonave rurale

Shqipëria do të përshtasë përcaktimin formal të zonave rurale në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe INSTAT-in. Kualifikimi për mbështetje për zhvillimin rural, për shumicën e programeve, do të përcaktohet më shumë në bazë të karakteristikave (dhe sidomos punësimit) të përfituesve se sa nga vendi ku jetojnë ata. Kështu fermtat që ndodhen brenda kufijve administrative të zonave urbane nuk do të përjashtohen nga mbështetja për zhvillimin rural. Disa programe do të kufizohen vetëm në komunitete që ndodhen në zonat rurale. Përkufizimi i zonave rurale do të bazohet në vendbanimet që do të përcaktohen sipas densitetit të popullsisë. Baza e klasifikimit do të jetë përkufizimi standard i OECD-së (dendësi e popullsisë më pak se 150 njerëz për kilometër katrorë). Njësitë administrative (si p.sh. komunat), ku më shumë se 25% e popullsisë jeton në zona rurale, do të klasifikohen si rurale. Atje ku të dhënat për dendësinë e popullsisë nuk gjenden dot kollaj, do të përdoret përkufizimi standard i kufijve administrativë të qytetit derisa të gjenden të dhënat.

VII. PËRPUTHSHMËRIA DHE NDËRVEPRIMI I STRATEGJISË

VII.1 Përputhshmëria e planit me dokumente të tjera strategjike europiane dhe ndërkombëtare dhe planet e veprimit

Përputhshmëria në mbështetjen e zhvillimit rural, në vend të prodhimit bujqësor, është në linjë me marrëveshjet e OBT-së. Edhe fokusi tek aftësia për të konkurruar është në përputhje me liberalizimin e tregut.

Masat e parashikuara për pyllëzim do të kontribuojnë në zbatimin e vendimeve të protokollit

të Kiotos dhe të konventës kundër degradimit. Rikthimi i potencialit prodhues, si dhe futja e masave parandaluese është në përputhje me prioritetet e Konferencës së Ministrave mbi Mbrojtjen e Pyjeve në Europë.

Mbështetja për trajnime në fushën e teknologjive të reja të informacionit për prodhuesit bujqësorë brenda aksit I dhe nëpërmjet mbështetjes për hapjen e klubeve të kompjuterëve dhe qendrave informuese në fshat brenda kuadrit të aksit III, do të realizohet prioriteti europian për futjen e ICT-së në bujqësi dhe në zonat rurale.

VII.2 Koordinimi ndërmjet zonave prioritare

Brenda aksit të parë do të ketë mbështetje për fermat gjysmë të subvencionuara, të cilat do të plotësohen me shërbime konsulence, trajnime dhe mbështetje për organizimin në shoqata prodhuesish, nën akset III dhe IV, me qëllim që të sigurojnë tregje më të mira për anëtarët e tyre. Kushtet paraprake për prodhimet biologjike do të sigurohen nëpërmjet trajnimit dhe mbështetjes me investime, gjë që kërkon koordinim ndërmjet aksit I dhe aksit II. Edhe organizatat e prodhuesve të produkteve organike mund të përfitojnë nga mbështetja nëpërmjet akseve III dhe IV.

Masa “Trajnim” nën aksin I do të përdoret për marrjen e njohurive bazë mbi praktikën ekologjike në menaxhimin e tokës, nga e cila do të përfitojnë edhe masat e aksit II. Fermerët e trajnuar do të jenë përfitues të mundshëm nën masat NAEP-së.

Përpilimi i planeve të menaxhimit për zonat e Natura 2000, nën aksin II, do të mbështeten nga masat e aksit III.

Nëpërmjet mbështetjes për prodhuesit bujqësorë në zonat malore brenda aksit 2, do të vendosen kushte paraprake për mbrojtjen e mjedisit dhe atraktivitetit të tij kushte të mira bujqësore dhe mjedisore. Mbështetja do të plotësohet me mbështetjen për diversifikimin e aktiviteteve jashtë bujqësisë (p.sh. turizmit rural, zejtarisë) në aksin III.

Koordinimi ndërmjet modernizimit të fermave dhe diversifikimit do të jetë i madh, sepse shumë oportunitete për biznes të mbështetura nga aksi III do të kenë lidhje të rëndësishme ekonomike dhe individuale me praktikën bujqësore të mbështetura nën aksin I.

VI - 36 -I.3 Përputhshmëria me strategjitë e tjera sektoriale dhe ndërsektoriale

Strategjia e zhvillimit rural është e lidhur ngushtë me strategjinë e Bujqësisë, e cila përshkruan qëllimet dhe politikat për shërbimet e ofruara nga MBUMK-ja. Shumë nga këto shërbime ofrojnë mbështetje teknike dhe institucionale për të bërë të mundur që aktivitetet rurale të jenë të suksesshme. Një shërbim ekstensional i modernizuar do të jetë burim kryesor këshillimi për fermerët në modernizimin, diversifikimin dhe zgjerimin e bizneseve, si dhe certifikimi i cilësisë së produkteve merr një rëndësi të veçantë. Edhe ujitja është një pjesë e rëndësishme e modernizimit të fermave dhe angazhimet për konsolidimin e reformave të tregut të tokës do të luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e fermave të një madhësie të pranueshme për të përfituar nga mbështetja për zhvillimin rural. Institucionet veterinarë dhe ato të mbrojtjes së bimëve do të ofrojnë mbështetjen e nevojshme që fermerët të mund të shfrytëzojnë maksimalisht mbështetjen për vlerën e shtuar dhe tregun, që do të jepet nga programet e zhvillimit rural.

Strategjia ndërsektoriale e mjedisit mbulon cilësinë e ajrit, ndryshimin e klimës, energjinë, ujin dhe mbetjet, mbrojtjen e tokës, biodiversitetin, menaxhimin në përdorimin e tokës (kryesisht për zonat urbane) dhe dëmtimin e mjedisit (e lidhur sidomos me industrinë). Problemet kryesore që ndikojnë në zonat rurale do të trajtohen në strategjinë e zhvillimit rural. Politikat e zhvillimit rural për agromjedisin do të ndihmojnë në reduktimin e ndotjes së burimeve ujore që vijnë nga bujqësia dhe pylltaria dhe do të ndihmojnë në nxitjen e bashkëpunimit mes fermerëve për fuqizimin e zonave të mbrojtura. Mbështetja për zhvillimin rural nën zhvillimin rural do të përmirësojë higjienën rurale. Mbështetja për pjesëmarrjen në zhvillimin rural, nën aksin e katërt të zhvillimit rural, do të jepet për të ndihmuar komunitetet për të bashkëpunuar në zgjerimin dhe fuqizimin e zonave të mbrojtura. Procesi i decentralizimit të menaxhimit të pyjeve është shumë i rëndësishëm.

Bashkëpunimi me strategjinë ndërsektoriale të zhvillimit rural është një komponent i rëndësishëm. Për shkak se strategjia e zhvillimit rural nuk mund të përfundojë para vitit të ardhshëm, ky do të jetë një proces pune në vazhdim. Do t'i kushtohet kujdes i veçantë arritjes së një marrëveshjeje për përcaktimin e përgjegjësisë për mbështetjen ndaj zhvillimit të ndërmarrjeve. Zhvillimi rural do të bazohet te ndërmarrjet e bazuara te bujqësia, përfshi këtu edhe aktivitetet për vlerën e shtuar dhe marketingut, si dhe në veprimtaritë e ndërmarrjeve të vogla jobujqësore. Zhvillimi rural do të fokusohet në zhvillimin e ndërmarrjeve më të mëdha jobujqësore në zonat rurale.

MBUMK-ja dhe Ministria e Ekonomisë do të kenë bashkëpunim të ngushtë që të shfrytëzohet me efikasitet, kapaciteti implementues në zhvillimin lokal.

I njëjti bashkëpunim do të kërkohet edhe nga MPPTT-ja në zbatimin e strategjisë së furnizimit me ujë dhe transportit. Fillimisht, kjo do të realizohet nëpërmjet procesit të raportimit rural “rural proofing”, megjithëse nuk përjashtohet edhe bashkëpunimi në terren, duke përdorur kapacitetin lokal në menaxhimin e projekteve të MPPTT-së.

ANEKSI 1: LISTA E DOKUMENTEVE TË REFERUARA (PËR T”U PLOTËSUAR)

Plani Kombëtar Strategjik për Zhvillimin Rural 2007-2013, Republika e Bullgarisë

Plani Kombëtar Strategjik për Zhvillimin Rural 2007-2013, Republika e Sllovenisë, Shqipëria, rritja e qëndrueshme gjatë tranzicionit, WB, 2002

Strategjia e Shqipërisë, EBRD, 2002

Shqipëria: Llogaritja e varfërisë, WB, 2003

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik dhe Ulja e Varfërisë, SZHES, 2001

Politikat e Eksencionit Bujqësor, MBUMK, 2001

Zhvillimi Rural në Bashkimin Europian, EU, 2003

Agenda 2000 Europiane, EU 1999

Raporti vjetor 2005, Banka e Shqipërisë

“Strategjia Shqiptare e Zhvillimit Rural:”, Frauke Jungbluth (World Bank) and David Lugg (FAO), 2002.

“Arritjet e Qëllimeve të Mijëvjeçarit në Shqipëri”, UNDP, Shqipëri 2004

“Strategjia Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social, Plani 2003-2006 i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Bujqësisë Ushqimit SKZHES Njësia e Monitorimit, Tiranë 2003.

“Raporti vjetor 2003”, Ministria së Bujqësisë dhe Ushqimit.

“Programi i punës 2002-2005 Ministria së Bujqësisë dhe Ushqimit”, Tiranë 2002.

“Strategjia e Bujqësisë dhe Ushqimit”, Republika e Shqipërisë, Ministria e Bujqësisë Ushqimit, Tiranë, 2003.

Raporti i Misionit VAKAIS International S.A. Greece, mbi Zhvillimin Rural në Shqipëri Nëntor, 2004

Vlerësimi i Misionit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, nga njësia TAIEX, në bashkëpunim të ngushtë me DG- Agricultur dhe zhvillimin rural me Komisionin Europian, nëntor 2005.

“Fact Sheet: Zhvillimi Rural në Europën e Bashkuar”, EC 2003.

“Udhëzimet për ndryshimin nga SAPARD në instrumentet paraardhëse për zhvillimin rural (2004-2006)”, 17.9.2003.

“Propozimet për Rregulloren e Këshillit mbi mbështetjen e zhvillimit rural nga Fondet Bujqësore Europiane për Zhvillimin Rural (EAFRD)”, Bruksel 14.7.2004, COM(2004)490 final, 204/0161(CNS).

“Proposal for a Council Regulation on support to Rural Development by the European Agricultural Fund for Rural Development: EXTENDED IMPACT ASSESSMENT”, Commission Staff Working Document, COM(2004)490 final.

Direktivat e Këshillit 20 shkurt 2006 dhe udhëzimet komunitare për zhvillimin rural (programimi për periudhën 2007 - 2013) 2006/144/EC

Regullore e Këshillit (EC) nr.1698/2005 i 20/shtatorit 2005, mbi mbështetjen për zhvillimin rural nga Fondi Bujqësor Europian për zhvillimin rural (EAFRD).

**KOSTOJA E PROJEKTVENDIMIT PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIAL TË
ZHVILLIMIT RURAL 2007-2013**

Tabela 1.

Emertimi	Viti 2006		Viti 2013	
	%	M /lek	M/lek	% total
Aksi 1				
Modernizimi i fermave	35.8%	2,633	4,675	27.5%
Vlera e shtuar / Marketingu	2.9%	210	2,550	15.0%
Pyjet	5.0%	369	850	5.0%
Trainim / Shërbimi i këshillimit	0.0%	0	425	2.5%
<i>Totali</i>	<i>43.7%</i>	<i>3,213</i>	<i>8,500</i>	<i>50.0%</i>
Aksi 2				
Zonat më pak të favorizuara	21.2%	1,558	170	1.0%
Agro-mjedisi & Natura 2000	0.0%		1,530	9.0%
<i>Totali</i>	<i>21.2%</i>	<i>1,558</i>	<i>1,700</i>	<i>10.0%</i>
Aksi 3				
Punësim jashtë fermës	0.0%	0	1,190	7.0%
Cilësia e jetës rurale / Infrastruktura	35.1%	2,583	4,760	28.0%
<i>Totali</i>	<i>35.1%</i>	<i>2,583</i>	<i>5,950</i>	<i>35.0%</i>
Aksi 4				
Pjesëmarrja në zhvillim		0	850	5.0%
Totali	100.0%	7,355	17,000	100.0%

Shënime: Burimi buxheti i shtetit për vitin 2006

Kjo analizë financiare i referohet investimeve të realizuara nga Buxheti i Shtetit dhe donatorë të ndryshëm për vitin 2006, të cilët operojnë në fushën e zhvillimit rural. Me informacionin e disponuar jemi munduar të ndajmë zërat e investimeve sipas akseve dhe masave përkatëse, si më poshtë:

- modernizimi i fermave - mbështetje për investime për të ndihmuar fermat të përmirësojnë prodhimin dhe efikasitetin, të fusin praktika të reja, t'i zgjerojnë dhe konsolidojnë;
- vlera e shtuar dhe marketingu - mbështetje në ndihmë të fermerëve dhe grupeve të fermerëve për furnizimin e tregut të brendshëm dhe të jashtëm, përfshi edhe përmbytjen e standardeve të cilësisë;
- pyjet - mbështetje për investime për përmirësimin e cilësisë së menaxhimit të pyjeve;
- trajnimi dhe asistencë teknike — mbështetje për zhvillimin e aftësive të fermerët dhe për ata që punojnë në rrjetin e fermave;
- LFA - mbështetje për fermerët në zonat e pafavorizuara (përfshi dhe zonat malore);
- agromjedisi - pagesa për fermerët për t'i inkurajuar të menaxhojnë mjedisin.

Komente mbi përputhshmërinë e strategjisë së bujqësisë dhe strategjisë së zhvillimit rural, me rregulloret e BE-së

Vendim i Këshillit në 20 shkurt 2006, direktivat strategjike të Komunitetit për zhvillimin rural (programimi për periudhën 2007-2013), 2006/144/EC.

Këshilli i Europës së Bashkuar, duke pasur parasysh themelimin e Bashkimit Europian.

Rregulloren e këshillit 1698/2005 të 20 shtatorit 2005, për mbështetjen e ZHR-së nga fondi i bujqësisë për zhvillimin rural (EAFRD) dhe veçanërisht artikulli 9(2):

1. artikulli (1) 1 Reg 16 98/2005 jep direktivat strategjike për zhvillimin rural për periudhën e programuar, nga 1 janari 2007 deri në 31 dhjetor 2013, duhet të adaptohet në nivel të Komunitetit dhe të përcaktohen prioritetet e zhvillimit rural;

2. këto direktiva strategjike, duhet që të reflektojnë në rolin multifunksional të fermës, në pasurimin dhe diversifikimin e peizazhit, prodhimit bujqësor, si dhe trashëgimisë natyrore kudo në Komunitet;

3. këto direktiva strategjike, duhet që të indentifikojnë zonat më të rëndësishme për të realizuar prioritetet e Komunitetit, sidomos sipas orientimeve të Gotenborgut mbi qëllimin e qëndrueshmërisë së strategjisë së përtëritë të Lisbonës për rritje dhe krijim punësimi;

4. në bazë të këtyre direktivave çdo anëtar i BE-së, duhet të përgatisë planin strategjik të tij kombëtar në referencë të kuadrit të përgatitjes të programit të zhvillimit rural.

Rregullorja e Këshillit (EC) nr.1698/2005 e 20 shtatorit 2005 (amenduar nga rregullorja 1944/2006 bën fjalë për “Mbështetjen e zhvillimit rural nga fondi bujqësor european për zhvillimin rural (EAFRD)”.

1. Objektivat dhe rregullat e përgjithshme bazohen dhe janë përshtatur sipas titullit të nenit 4, ku theksohet që mbështetja e zhvillimit rural duhet të kontribuojë në arritjen e objektivave të mëposhtme:

i) përmirësimi i konkurrueshmërisë në bujqësi e pyje, duke mbështetur ristrukturimin, zhvillimin dhe rinovimin (përtëritjen);

ii) përmirësimi i ambientit në fshat duke mbështetur menaxhimin e tokës;

iii) përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale dhe inkurajimi i diversifikimit të aktiviteteve ekonomike.

2. Masat e përshkruara në strategjinë e zhvillimit rural janë përshtatur bazuar në titullin IV të rregullores në fjalë, kapitulli i ndarë sipas akseve:

- përmirësimi i konkurrueshmërisë në sektorët e bujqësisë dhe pyjeve të shoqëruara me disa masa, të cilat do të përzgjidhen nga nenet përkatëse 20 - 35 të rregullores 1698/2005;

- përmirësimi i ambientit dhe i fshatit, i cili do të shoqërohet me masat e përshkruara dhe do t'i përshtaten kushteve dhe prioritetet të vendit tonë, sipas neneve 36 deri 51 të rregullores së BE-së 1258/99;

- cilësia e jetesës në zonat rurale dhe diversifikimi i ekonomisë rurale, i cili do të shoqërohet me masat e përshkruara dhe do t'i përshtaten kushteve dhe prioritetet të vendit tonë, sipas neneve 52 deri 60 të rregullores së BE-së 1258/2005;

- përqasja LIDER, i cili do të shoqërohet me masat e përshkruara dhe do t'i përshtaten prioritetet të vendit tonë, sipas neneve 61 deri 68 të rregullores së BE-së 1258/2005.

3. Të gjitha masat dhe objektivat janë të shtjelluara dhe nga vendimi i Këshillit në 20 shkurt 2006, i shoqëruar nga direktivat strategjike të Komunitetit për zhvillimin rural (programimi për periudhën 2007-2013), 2006/144/EC.

Rregullorja e Komisionit (EC) nr.1974/2006 e 15 dhjetorit 2006 përshkruan në detaje rregullat për zbatimin e rregullores nr.1698/2005 mbi fondin bujqësor european për zhvillimin rural.

Neni 43 i rregullores nr.1257/1999 specifikon strukturën e PZHR-së duke deklaruar se ajo duhet të përfshijë:

- një përshkrim sasior të situatës aktuale që tregon pabarazitë, boshllëqet dhe mundësinë për zhvillim, burimet financiare dhe rezultatet kryesore të operacioneve të ndërmarra në periudhën e mëparshme të programimit duke marrë parasysh rezultatet vlerësuese në dispozicion;

- një përshkrim të strategjisë së propozuar, objektivat e saj sasiorë, prioritetet e zgjedhura të zhvillimit rural dhe zona gjeografike të mbuluara;

- një vlerësim që tregon ndikimin ekonomik, mjedisor dhe social që pritet, duke përfshirë edhe efektet e punësimit;

- një tabelë treguese financiare që përmbledh burimet e siguruara financiare kombëtare nga Komuniteti dhe që i korrespondon çdo prioriteti të zhvillimit rural të paraqitur në kontekstin e planit;

- një përshkrim i masave të parashikuara për zbatimin e planeve, dhe në veçanti skemat e ndihmës, duke përfshirë pikat e nevojshme për vlerësimin e rregullave të konkurrencës;

- aty ku shihet me vend, informacion mbi nevojat për çdo studim, projektet e demonstrimit, operacione trajnimi ose të asistencës teknike në lidhje me përgatitjen, zbatimin ose adaptimin e masave përkatëse;

- përcaktimi i autoriteteve dhe organizmave kompetente përgjegjëse;

- dispozitat për të siguruar zbatimin efikas dhe korrekt të planeve, duke përfshirë monitorimin dhe vlerësimin, një përcaktim të treguesve sasiorë për vlerësim, veprime për kontrolle dhe sanksione, si dhe publiciteti i duhur;

- rezultatet e konsultimeve dhe emërimit të autoriteteve dhe organizmave të lidhura, si dhe partnerët ekonomikë dhe socialë në nivelet e duhura.

E njëjta rregullore specifikon që PZHR-ja duhet:

- të sigurojë për masat agromjedisore në të gjithë territorin dhe në përputhje me nevojat e saj specifike;

- të sigurojë ruajtjen e balancimit të nevojshëm midis masave të ndryshme mbështetëse.

Ngritja e Agjencisë së Pagesave bazohet në rregulloret e mëposhtme;

Rregullorja e Këshillit (EC) nr.1268/99 e 21 qershorit 1999 mbi mbështetjen e Komunitetit për masat e paraaderimit për bujqësinë dhe zhvillimin rural në vendet aplikante të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore në periudhën para hyrjes në Bashkimin European.

Ndryshuar (amended) nga:

Rregullorja (EC) no 696/2003 e 14 prillit 2003;

Rregullorja e Këshillit (EC) nr.1698/2005 e 20 shtatorit 2005;

Rregullorja e Komisionit (EC) nr.1974/2006 e 15 dhjetorit 2006;

Agjencia e Pagesave SAPARD (tani IPARD).

Në marrëveshjen e paraaderimit për IPA-në (instrumenti i paraaderimit), parashikohet, që secili vend aplikant duhet të krijojë agjencinë e pagesave, e cila duhet të ketë funksione implementimi, si dhe të kryejë pagesat.

Funksionet e organizmit zbatues do të përfshijnë: seleksionimin e projekteve, tenderimin, kontraktimin, kontrollin e aplikimeve, kontroll në bazë, aprovimin, monitorimin dhe raportimin progresiv. Funksionimi i agjencisë së pagesave do të përfshijë dhe kontrollin e faturave të pagesave, në terren, të autorizojë ekzekutimin e pagesave, si dhe të mbajë rekorde të rregullta në librat e financës sipas udhëzimeve përkatëse të Bashkimit European.

Krijimi i një agjencie pagesash është kërkesë e rregullores së Këshillit të Europës (EC) nr. 1258/99 dhe rregullores së Komisionit European nr.1663/95, ku theksohet që çdo vend aplikant do të komunikojë me Komisionin European nëpërmjet autoritetit apo organizmave të akredituara për të bërë pagesat e shpenzimeve nga buxheti i Komunitetit European, të ashtëquajtura (Agjenci pagesash). Rregullorja 1258/99 e përcakton Agjencinë e Pagesave si një autoritet të akredituar ose organizëm i vendit aplikues, i cili realizon pagesat e shpenzimeve nga fondi bujqësor european për zhvillimin rural (EAFRD) seksionit të garancisë. “Vetëm shpenzime të bëra nga agjencitë e pagesave të akredituara, mund të jenë subjekt i financimeve komunitare”. Agjencia SAPARD (tani IPARD) do të jetë një institucion financiar i vendeve aplikuese, të cilat për arsye të pagesave në zonën e tyre do të përgjigjen dhe ofrojnë garancinë e nevojshme për:

1. pranimin e kërkesave në përputhje me rregullat e Komunitetit European, si dhe kontrollin e pagesave përpara sesa të autorizohen për t’u ekzekutuar;

2. pagesat duhet të kryhen në mënyrë korrekte dhe të bëhet një regjistrim i plotë në librat e llogarisë;

3. dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen në kohë dhe në formatet e caktuara në rregullat e Komunitetit European.

Kriteret e akreditimit të këtyre lloj agjencive duhet që të garantojnë dhe sigurojnë një funksion të rregullt: i) të organizmit administrativ; ii) të sistemit të kontrollit të brendshëm; dhe iii) mbajtja e dokumenteve sipas nenit 4 të rregullores nr.1258/99. Aneksi i rregullores nr.1663/95, përshkruan kriteret e akreditimit, përcakton krijimin e Agjencisë së Pagesave si një akt formal, dhe i jep fuqi, përcakton detyrimet dhe përgjegjësitë si dhe strukturën administrative.

- Neni 9(1) i rregullores nr.1258/99 thekson se mbështetja financiare duhet të jetë në përputhje me principet e përshkuara nga rregullorja nr.1258/99.

- Një bazë solide ligjore duhet të bëhet si një kusht i detyrueshëm për të përdorur fondet e paraaderimit, në rastin tonë fondet IPA-së.

VENDIM I KËSHILLIT

Në 20 SHKURT 2006 dhe rregullores Reg 16 98/2005 , etj, të BE

Tabela.1

Direktivat Strategjike të Komunitetit për Zhvillimin Rural 20 Shkurt 2006/144/EC.

Plotësisht i përputhshëm

A

b	c	d	e
1.Artikulli (1) i Reg 16 98/2005 jep direktivat strategjike për Zhvillimin Rural për periudhen e programuar nga 1 Janari 2007 deri 31 dhjetor 2013, që duhet të adaptohen në nivel të Komunitetit dhe te përcaktohen prioritetet e Zhvillimit Rural. 2.Këto direktiva strategjike duhet që të reflektojnë në rolin multifunksional të fermës, në pasurimin dhe diversifikimin e pejsazhit, prodhimit bujqësor, si dhe trashëgimisë natyrore kudo në komunitet. 3.Këto direktiva strategjike duhet që të identifikojnë zonat më të rëndësishme për të realizuar prioritetet e Komunitetit, sidomos sipas orientimeve të Gottenborgut mbi qëllimin e qëndrueshmërisë dhe strategjisë së përtërirë të Lisbonës për rritje dhe krijim punësimi, nga Këshilli i Europës në Gottenborg (13-16 June 2003)	1.Në përputhje me kapitullin II të Strategjisë së Zhvillimit Rural ,qëllimi i strategjisë,kohëzgjatja e strategjisë, prioritetet e strategjisë si edhe synimet e sajë. 2.Në përputhje me kapitullin IV tw Strategjisë së Zhvillimit Rural për rritjen e konkureshmërisë së fermës, modernizimin e sajë, diversifikimi i aktiviteteteve në zonat rurale, ruajtja e peisazhit si dhe përdorimi i pasurive natyrore dhe ato të trashëguara në mënyrë të qëndrueshme, 3.Në përputhje me kapitullin e IV politikat dhe veprimtaritë, për krijimin e vendeve të reja të punës jashtë sektorit bujqësor	i plotë i plotë i pjesëshëm	Viti 2008 Viti 2008 Viti 2013
		Këto direktiva nuk mund të adoptohen plotësisht mbasi duhet që të përfundojnë planet e veprimit të plota në cdo rajon si dhe të përcaktohen mundësitë për një punësim më të përmirësuar	

4.Në bazë të këtyre direktivave çdo anëtar i BE, duhet të pregatiti planin strategjik të tijë kombëtar në referencë të kuadrit të pregatitjes të programit të Zhvillimit Rural.	4.Draft plani i strategjisë ndër-sektoriale për Zhvillimin rural është pregatitur.	i plotë	Me urdhër të Kryeministrit u ngrit grupi i punës, ndërmintor, i cili në bashkëpunim me aktorët e nevojshëm pregatiti draftin e strategjisë.	Viti 2008
5.Titulli I, kapitulli I" qëllimi dhe përcaktimet. Neni 2(përcaktimet), Reg 16 98/2005	5.Në përputhje me kapitullin e II të strategjisë së Zhvillimit Rural të Shqipërisë, qëllimi i strategjisë,kohëzgjatja e strategjisë, prioritetet e strategjisë si edhe synimet e sajë.	i plotë		Viti 2008
6..Titulli I, Kapitulli II, neni 4 (Objektivat), mbështetje për zhvillimin duhet të kontribojë për aritjen e objektivave të me poshtem; a) përmirësimi i konkureshmërisë në bujqësi..... b) përmirësimi i ambjentit.... c) përmirësimi i cilësisë së jetesës..... 7. neni 11,12 dhe 16. Reg 16 98/2005	6.Në përputhje me kapitullin e IV të strategjisë së Zhvillimit Rural të Shqipërisë a) përmirësimi i konkureshmërisë në bujqësi.... b) përmirësimi i ambjentit.... c) përmirësimi i cilësisë së jetesës 7.Plani kombëtar për bujqësinë dhe zhvillimin rural, qëllimi i planit, termat, kriteret dhe plani financiar 8.Në përputhje me kapitullin e VI menaxhimi dhe buxheti 9.Në përputhje me kapitullin IV të strategjisë së zhvillimit rural, aksi parë konkureshmëria e sektorit bujqësor, agrobiznesit dhe pyjeve.	i pjesëshëm	Këto objektiva i janë përshatur kushteve reale të vëndit tonë, duke përcaktuar prioritetet kryesore si infrastruktura e dobët dhe zhvillimi i bujqësisë. Për arsye se ky plan pregatitet në një fazë të më vonshme.	Viti 2013
8. neni 70 kontributi financiar, Reg 16 98/2005		i pjesëshëm	Për arsye të mos përfitimit nga të gjithë komponentët e programit mbështetës të BE IPA	Viti 2013
9.. neni 20. Aksi I "Përmirësimi i konkureshmërisë i sektorit të bujqesise dhe pyjeve" Masat , Reg 16 98/2005		i pjesëshëm	Masat që e plotësojnë këtë aks nuk mund që të përputhen plotësisht për mungesë të fondeve duke mos qëndrë vënd anëtar i bashkimit European	Viti 2013
		i pjesëshëm	Masat që e plotësojnë këtë aks nuk	Viti 2013

10. neni 36 Aksi II "Permiresimi i Mjedisit dhe peisazhit te fshatit" Masat Reg 16 98/2005	10. Në përputhje me kapitullin IV te strategjisë së zhvillimit rural, aksi i dytë ruajtja e peisazhit kulturor dhe mbrojtja e mejdisit		mund që të përputhen plotësisht për mungesë të fondeve duke mos qënë vënd anëtar i bashkimit European	Viti 2013
11. neni 52 Aksi III Permiresimi i cilesise se jeteses ne zonat rurale dhe diversifikimi i aktiviteteteve ekonomike , Reg 16 98/2005	11. Në përputhje me kapitullin IV te strategjisë së zhvillimit rural, aksi tretë permiresimi i cilësisë së jetës në zonat rurale dhe promovimi i diversifikimit.	i pjesëshëm	Masat që e plotësojnë këtë aks nuk mund që të përputhen plotësisht për mungesë të fondeve duke mos qënë vënd anëtar i bashkimit European	Viti 2013
12. neni 61 Aksi IV përcaktimi i perqasjes Leader , Reg 16 98/2005	12. Në përputhje me kapitullin IV te strategjisë së zhvillimit rural, aksi katërt pjesëmarrja në zhvillimin rural	i pjesëshëm	Masat që e plotësojnë këtë aks nuk mund që të përputhen plotësisht për mungesë të fondeve duke mos qënë vënd anëtar i bashkimit European	Viti 2013
13. neni 74 dhe 75 vëndet anëtare duhet të adoptojnë anën legjislative sipas nenit 9(1) të rregullores së BE Nr 1290/2005 autoriteti menaxhues duhet që jetë i përgjegjshëm për zbatimin e zhvillimit rural në mënyrë korrekte	13. Në përputhje me kapitullin VI te strategjisë së zhvillimit rural, mbi menaxhimin dhe buxhetin	i pjesëshëm		Viti 2013
14. Rregullorja 12 58/99 artikulli 4/1 mbi krijimin e agjensisë së pagesave dhe rregullorja (EC) No 1290/2005 sipas nenit	14. Në përputhje me kapitullin VII te strategjisë së zhvillimit rural, monitorimi dhe vlerësimi si edhe ngritja e agjensisë së pagesave.	i pjesëshëm		Viti 2013
15 Rregullorja mbi akreditimin e agjensisë së pagesave, artikulli 7 i rregullores (EC) No 1290/2005, mbi njësinë certifikuese	15. Në përputhje me kapitullin VII te strategjisë së zhvillimit rural, monitorimi dhe vlerësimi si edhe ngritja e agjensisë së pagesave.	i pjesëshëm		Viti 2013
16. Rregullorja e këshillit Nr 1782/2003 neni 20	16. Në përputhje me kapitullin VII te strategjisë së zhvillimit rural, monitorimi dhe vlerësimi si			

i cili bën fjalë për pagesat të cilat duhet që autorizohen nga autoriteti kombëtar tek përfituesi nëpërmjet një skeme të përcaktuar. 17. Rregullorja e kështillit Nr 1782/2003, neni 24, i cili flet për rritjen e konkureshmërisë së produkteve bujqësore, cilësinë dhe rritjen e standarteve 18. Agjensia e pagesave, do të funksionojë sipas praktikave dhe udhëzimeve të rregulloreve të bashkimit evropian dhe rregullat financiare të vëndit, kapitulli VII pika 1, Agjensia e pagesave do të përgjigjet për sigurimin e raporteve të monitorimit dhe drejtorja e Zhvillimit rural do të vlerësojë.	edhe ngritja e agjensisë së pagesave. 17. Në përputhje me kapitullin IV të strategjisë së zhvillimit rural, aksi i parë për rritjen e konkureshmërisë në ferma dhe pyje. 18. Ngritja e Agjensisë së Pagesave bazohet në rregulloret e më poshtme; Rregullorja e kështillit (EC) Nr 1268/99 e 21 Qeshorit 1999 mbi mbështetjen e komunitetit për masat e para-aderimit për bujqësinë dhe zhvillimin rural në vëndet aplikante të vëndeve të Europës Qëndrore dhe Lindore në periudhën para- hyrjes në Bashkimin Evropian Ndryshuar (amended) nga: Rregullorja (EC) No 696/2003 e 14 Prillit 2003 Rregullorja e Kështillit (EC) Nr 1698/2005 e 20 shtatorit 2005 Rregullorja e Komisionit (EC) Nr 1974/2006 e 15 dhjetorit 2006	i pjesëshëm i pjesëshëm i pjesëshëm i pjesëshëm	Agjensia e pagesave do të ngrihet fillimisht në vitin 2008 me fondet e Qeverisë shqiptare, dhe me vonë do të nënshtrohet procedurave të akreditimit nga Bashkimi Evropian për të përfituar në të ardhmen fondet mbështetëse të IPARD.	Viti 2013 Viti 2013 Viti 2013 Viti, 2010
--	--	---	--	--

Strategjia Ndër-sektoriale Shqiptare e zhvillimit rural					Tabela 2.	
Strategjia ndër sektoriale Shqiptare e Zhvillimit Rural 2007 – 2013						
Përputhshmëri e pjesëshme						
a	b	c	D	f		
Strategjia Ndërsektoriale Shqiptare e zhvillimit rural 1. Qëllimi i strategjisë është që të shërbejë si një bazë kombëtare, me qëllim realizimin e prioriteteve, të cilat shoqërohen me krijimin e vëndeve të reja pune, rritje të prodhimit dhe zhvillim të qëndrueshëm.	Strategjia Ndërsektoriale Shqiptare e zhvillimit rural 1. Direktivat Strategjike të Komunitetit për Zhvillimin Rural 20 Shkurt 2006/144/EC. Titulli I, kapitulli I” qëllimi dhe përcaktimet. Neni 2 (përcaktimet) të rregullores 16 98/2005 Direktivat strategjike të Komunitetit për Zhvillimin Rural do të ndihmojnë në; - Identifikimi i zonave ku suporti i BE për Zhvillimin Rural krijon më shumë vlerë të rritur në nivel të BE - Bëhet lidhja me prioritetet Europiane (Lisbon, Gøtenborg) duke I përkthyer ato në politika të zhvillimit Rural - Siguron vijueshmërinë me politikatat e tjera Europiane, veçanërisht në atë të Kohezionit dhe ambjentit - Shoqëron implementimin e politikave të orientimit të tregut të përbashkët bujqësor (CAP) dhe risrukturimin e nevojshëm të detyrueshëm për vëndet e reja dhe të vjetra.	i plotë	Strategjia jonë është në përputhshmeri me vendimin e këshillit të europës, e cila përfshin jo vetëm zhvillimin rural por dhe atë bujqësor si element kryesor për kushtet tona	Viti 2013		

4. Titulli I, Kapitulli II, neni 4 (Objektivat), mbështetje për zhvillimin duhet të kontribuojë për arrijen e objektivave të mëposhtme; a) përmirësimi i konkurrenshmërisë në bujqësi.... b) përmirësimi i ambjentit.... c) përmirësimi i cilësisë së jetesës Politikat dhe veprimtaritë: Strategjia e Zhvillimit Rural ka nëntë politika kryesore dhe katër akse të cilat janë të shoqëruara me aktivite specifike.	Për këto sfida Politikat e Përbashkëta Europiane dhe e ardhmja zhvilluese e tijë duhet që ndërmjet objektivave dhe kontributit të arrijë zhvillim të qëndrueshëm duke rritur përqëndrimin e tijë në inkurajimin e shëndetit, prodhime të cilësisë së lartë, metoda të qëndrueshme prodhuese ambjentale, përfshirja e produkteve organike, ripërtëritjes së lëndëve të para dhe mbrojtjes së biodiversitetit. Principet drejtuese kryesore u konfirmuan dhe në strategjinë e Lizbonës, konkluzionet e keshillit të Selanikut (20-21 qershor 2003). Reforma e Politikës së Përbashkëta Europiane dhe e Zhvillimit Rural mund të japë një kontribut të madh në konkurrenshmërinë dhe në një zhvillim të qëndrueshëm në vitet e ardhshme. 4. Direktivat Strategjike të Komunitetit për Zhvillimin Rural 20 Shkurt 2006/144/EC. Zhvillimi rural Në të ardhmen Zhvillimi Rural do të fokusohet në 3 fusha kryesore; ekonominë agropërpunuese, ambjentin si dhe zgjerimin e ekonomisë dhe popullsisë rurale. Gjeneracioni i ri i strategjisë së Zhvillimit Rural dhe programet do të ndërtohen rreth të ashtëquajturave 4 akse: 1. përmirësimi i konkurrenshmërisë në sektorët e bujqësisë dhe pyjeve,		
---	---	--	--

2.përmisimi i ambientit në fshat 3. cilësia e jetës në zonën rurale dhe shumëllojshmëria e ekonomisë rurale, 4. programi Leader. • Nën aksin e parë një sërë masash do të merren për kapitalin human dhe fizik në sektorët e bujqësisë, ushqimit dhe pyjeve (promovimi i transferimit të njohurive dhe inovimi(përtëritja) dhe cilësia e prodhimit. • Aksi dytë siguron masa mbrojtëse për rritjen e burimeve natyrore, konservimin e vlerës së lartë natyrore të fermës dhe të sistemit pyjor dhe kultura e pejsazhit European i Zonave Rurale. • Aksi i 3 ndihmon në zhvillimin e infrastrukturës lokale dhe kapitalit human në zonat rurale duke përmirësuar konditat për rritje dhe krijimin e punësisë në të gjithë sektorët dhe shumëllojshmërinë e aktiviteteve ekonomike. • Aksi i 4 bazuar në eksperiencën, prezanton mundësitë për qeverisje inovative (ripërtëritëse), në nivel lokal, nga poshtë lart për zhvillimin rural.			I plotë 2008
5. Menaxhimi, buxheti dhe kordinimi..			5. Direktivat Strategjike të Komunitetit për Zhvillimin Rural 20 Shkurt 2006/144/EC. Regullorja (EC) Nr 1698/2005 parashikon monitorimin strategjik te strategjise komunitare dhe ate kombetare. Baza e